

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverballi, mbledhja e parë e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 22.01.2026, në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Festim Pllana, Daut Krasniqi, Kushtrim Mirena, Kosovar Ademi, Hasime Kostanica, Filloreta Musaj, Arlinda Mekolli, Rrahim Sogojeva, Hajredin Mjeku, Mirlinda Krasniqi, Afrim Dumani, Laureat Gojnovci, Jetmir Berisha, Burim Berisha, Ali Topalli, Etnik Berjani, Saranda Sllamniku, Vjosa Kida Hyseni, Rrahim Tërnavë, Valon Murseli, Ermal Dumani, Aida Alimi, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Bashkim Krasniqi, Dashnim Bajrami, Ali Ismaili, Driton Ademi, Vildane Latifi dhe Radoman Dedorevic.

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Valon Prebreza - Kryetar i Komunës, Shpend Bardiqi - Nënkyetar i Komunës, Shefqet Zogaj - Drejtor për Administratë, Albana Gashi - Drejtoresha për Shëndetësi, Adriatik Zeqiri - Drejtor për Arsim, Taulant Kelmendi - Drejtor për Planifikim Urban, Bardhyl Kojcici - Drejtor për Buxhet dhe Financa, Durim Hajra - Drejtor për Inspektorat, Izja Mjeku - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, Gëzim Zogjani - Drejtor për Pronë, Arton Hajrullahu - Drejtor për Gjeodezi dhe Kadastër, Pranvera Merovci - Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik, Resul Makreshi - Drejtor për Teknologji Inovacion dhe Integritim Evropian

Të tjerë: Përfaqësues të Shoqërisë Civile dhe Media.

REND DITE

1. Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Aprovimi i Ekstraktit të Procesverballit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 04.12.2025.
3. Propozim për emërimin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete.
4. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
5. Propozim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
6. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për kompenzimin e anëtarëve të Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës.
7. Propozim për themelimin e Grupit Punues për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.
8. Propozim për caktimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi'.
9. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale 'Fushë-Kosova'.
10. Propozim për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 91, të datës 31.03.2022 për ndërtimin e Stacionit të Policisë në Fushë-Kosovë.

11. Propozim për dhënie në shfrytëzim të objektit të Ambulantës së Mjekësisë Familjare për Zyre Sektoriale Policisë së Kosovës në Fushë-Kosovë.
12. Propozim për rishqyrtimin e vendimeve për Projekt-Planit Zhvillimor Komunal për vitet 2025/2033.
13. Propozim për rishqyrtimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shkollës në fshatin Lismir.
14. Propozim për rishqyrtimi e vendimit për shujtën e punëtorëve të Administratës Komunale.
15. Propozim për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës me Nr. 68, të dates 25.07.2025.
16. Propozim për lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore primare në mjekësinë familjare për kategoritë me rëndësi të veçanta për sigurinë publike.
17. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, mirë se po takohemi në punimet e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, mbledhja e parë e rregullt në mandatin e ri 2025-2029, e para për vitin 2026, ju përshëndes të gjithëve dhe ju dëshiroj suksese dhe punë të mbarë, në këtë rrugëtim tonin dhe punimet tona në mbledhjet e Kuvendit të Komunës. Sipas konstatimit të gjithë asambleistët janë prezentë dhe kuorumi është i mjaftueshëm për të vazhduar me punimet e rregullta në këtë mbledhje të Kuvendit të Komunës, atëherë pa humbur kohë po fillojmë, menjëherë me rendin e ditës ashtu siç i keni pranuar dhe materialet, besoj të gjithë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës atëherë, po i lexojmë pikat një nga një deri në fund, pastaj i qesim në votim dhe i miratojmë si pako. Pika e parë e rendit të ditës është si vijon: Betimi i anëtarëve të rinjë të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, i kemi dy ndryshime është emërimi i anëtarit/es të ri/re të Kuvendit të Komunës z. Dashnim Bajrami, emërohet anëtarë i ri i Kuvendit nga subjekti politikë Partia Demokratike e Ashkalijnëve të Kosovës, duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit të Komunal z. Gëzim Gara, po ashtu edhe znj. Saranda Sllamniku e cila emërohet anëtare e re e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovë, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit të Komunës znj. Rineta Bërbatovci. Kjo është përmbajtja e pikës së parë të rendit të ditës. Pika e dytë e rendit të ditës, është 'Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës e datës 04.12.2025, pika e tretë është 'Propozim për emërimin e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete', ndërsa pika e katërt, duhet të ju njoftoj se kemi një ndryshim në përmbajtjen e pikës së katërt, për dallim nga materiali, te cilin e keni pranuar ju të gjithë, pika e katërt e rendit të ditës, sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkohet që të përfshihen të gjitha entitetet politike nëpër Komitetet e Përherëshme, në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komiteti për Komunitete, atëherë sipas udhëzimeve ligjore, që vijnë edhe për shkak të vullnetit që t'i përfshijmë të gjitha entitetet politike bëjmë një ndryshim të vogël, duke ju përshtatur udhëzimeve që vijnë nga ligji, përmbajtja e kësaj pike dhe anëtarëve të komitetit sipas udhëzimit administrative, komiteti ynë përbëhet ose duhet të jetë shtatë anëtarë prej të cilëve, po ashtu sipas udhëzimit administrativ Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e kryeson Komitetin për Politikë dhe Financa, e pastaj ndarja bëhet në bazë të përqindjeve dhe rezultateve të cilat i kanë arritur subjektet politike si në vijim: Lëvizjes Vetëvendosje i takojnë dy anëtarë të Komitetit për

Politikë dhe Financa, një anëtar i takon Lidhjes Demokratike të Kosovës, një anëtar është nga Partia Demokratike e Kosovës, një anëtar në bazë të numrit të votave ose përqindjes apo fuqisë politike me vota, që e kanë nga zgjedhjet e kaluara, normalisht këtu hyn edhe partitë e komuniteteve, por duke pasur parasysh edhe Udhëzimin Administrativ një anëtar i cili është anëtar i një komiteti, nuk mund të jetë anëtar i një komiteti tjetër, kështu që kemi parasysh se në mbledhjen e ardhshme në muajin shkurt, do të themelohet Komiteti për Komunitete, atëherë përfaqësuesit e komuniteteve, do të përfaqësohen në Komitetin për Komunitete, kështu që ne vazhdojmë me përfaqësuesit e partive të tjera, të cilat kanë zënë ulëse në Kuvendin e Fushë-Kosovës, e që vazhdojmë të përfaqësojësi i Zërit të Drejtësisë dhe përfaqësuesi i Nismës Socialdemokrate, kjo është përmbajtja e pikës së katërt të rendit të ditës, pastaj pika e pestë e rendit të ditës është 'Propozim për lehtësimin e mjeteve financiare për kompensimin e anëtarëve të Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës, këtu do të themelohen Komitete tjera dhe ajo do të bëhet me pagesën, e cila tashmë përmbajtja e saj, është në materialin të cilin e kemi para vetës. Pika e gjashtë e rendit të ditës është 'Propozim për themelimin e Grupit Punues për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026', pika e shtatë e rendit të ditës është 'Propozim për caktimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi', pika e tetë është 'Propozim për lehtësimin e mjeteve financiare për Ndërrmarrjen Publike Lokale "Fushë Kosova", pika e nëntë është 'Propozim për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 91, të datës 31.03.2022 për ndërtimin e Stacionit të Policisë në Fushë-Kosovë', pika e dhjetë është 'Propozim për dhënien në shfrytëzim të objektit të Ambulantës së Mjekësisë Familjare për Zyre Sektoriale Policisë së Kosovës në Fushë-Kosovë', pika e njëmbëdhjetë është 'Propozim për rishqyrtimin e vendimeve për Projekt-Planit Zhvillimor Komunal për vitet 2025/2033', pika e dymbëdhjetë është 'Propozim për rishqyrtimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shkollës në fshatin Lismir', pika e trembëdhjetë është 'Propozim për rishqyrtimin e vendimit për shujtën e punëtorëve të Administratës Komunale', pika e katërbëdhjetë është 'Propozim për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës me Nr. 68, të datës 25.07.2025', pika e pesëmbëdhjetë është 'Propozim për lirin nga pagesa e shërbimeve shëndetësore primare në mjekësinë familjare për kategoritë me rëndësi të veçanta për sigurinë publike' dhe pika e gjashtëmbëdhjetë 'Të ndryshme'. Atëherë në bazë të këtyre propozimeve unë hapi diskutimin dhe po fillojmë, me shprehjen e mendimeve të gjitha subjekteve politike, të marrim opinionin e secilit, po fillojmë me Lëvizjen Vetëvendosje, a pajtoheni për këtë përmbajtje të rendit të ditës.

Kosovar Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje: Lëvizja Vetëvendosje, pajtohet me përmbajtjen e rendit të ditës, për mbledhjen e sotme.

Laureat Gojnovci: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje, fillimisht dua të ju uroj të gjithë kolegëve, për rezultatin e treguar gjatë zgjedhjeve dhe qoftë ky një fillim i mbarë i punës së Kuvendit të Komunës, mbizotroftë harmonia dhe bashkëpunimi brenda këtij Kuvendi, në mënyrë që të përfitojnë qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës, sa i përket rendit të ditës, sot u pa ndyshimi pa paralajmërim paraprak, po ashtu është i mangët në mungesë të një pike po thuajse kryesore, e cila është 'Pyetje dhe Përgjigje Parlamentare, prej momentit kur ky ekzekutiv ka marrë pushtetin, mendoj se kanë ndodhur mjaftë gjëra, që sot të parashtrohen pyetje dhe të merren përgjigje parlamentare. E keni parë dje, se po thuajse ka evluar i gjithë rrjeti nga koleg/ë, që kanë plasuar materialin e Kuvendit dhe komentet e qytetarëve, që kanë dashur të ngrisin këto çështje për shqyrtim. Ku mundemi ne t'i ngrisim këto çështje, nëse nuk e kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje

parlamentare'. E dimë mirë që në mandatin e kaluar në dy mbledhje, kanë munguar pyetje dhe përgjigje parlamentare dhe është bërë një kaos këtu, është dëshmitarë Ish/Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Ali Ismaili, të cilit i është pamundësuar që të vazhdojë punën, në mungesë të kësaj pike të rendit të ditës, andaj është propozim i Lidhjes Demokratike të Kosovës, që të hyn në rendin e ditës pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', po ashtu Kryesues ne kërkojë që në plan të punës pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', të jetë pika e dytë e rendit të ditës, pasi që nuk jemi këtu për të krijuar situata të panevojshme, edhe me ardhur tek bllokimi i Kuvendit, po ashtu e theksuat shumë mirë ndryshimin e pikës katër, që ka të bëjë me komitete, unë kërkojë që kjo pikë të shtyhet, për arsye se ju e cituat nenin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, domethënë Ligji për Vetëqeverisje Lokale, që është neni 52 paragrafi 1, ku thotë se Komiteti për Politikë dhe Financa, kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe përbërja e tij, duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike. Kryesuesi tha që në bazë numrit të votave, me pas edhe një përfaqësim, Lidhja Demokratike e Kosovës, i ka nëntë anëtarë në Kuvendin e Komunës, Lëvizja Vetëvendosje i ka dhjetë anëtarë. Kryesues ju e theksuat shumë mirë, që kjo me përfaqësuar edhe fuqinë politike brenda Kuvendit të Komunës, a përfaqëson kjo përbërje e propozuar me propozimin shtesë që na erdhi sot, që e keni bërë këtë barazi brenda Kuvendit të Komunës, nëse Lëvizja Vetëvendosje i ka tre anëtarë në Komitetin për Politikë dhe Financa, me dhjetë anëtarë në Kuvendin e Komunës, ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës, me nëntë anëtarë në Kuvendin e Komunës, e ka një anëtarë, njëjtë sikur Zëri i Drejtësisë, me një anëtar një, Nisma SocialDemokrate një, prapë nuk është plotësuar udhëzimi administrative, sepse nuk përfaqësohet Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, nëse keni dashur më i përfaqësuar krejtë, është dashur me përfaqësuar edhe Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, unë kërkoj që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, me kërkuar një interpretim zyrtar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe në mbledhjen e ardhshme, së bashku me Komitetin për Komunitete me i dhanë edhe emrat, që mos të dalim as ne në një pozitë të palakmueshme, që pastaj me kërkuar anulim të këtij vendimi, përndryshe nëse nuk plotësohen këto dy kërkesa, ne nuk e votojmë rendin e ditës.

Migjen Kolshi: Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje, i uroj të gjithë kolegët të cilët e kanë fituar mandatin, sa i përket rendit të ditës, unë kisha shtuar vetëm tek pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', mendoj se do të ishte shumë e nevojshme, të ishte sot kjo pikë për arsye se prej marrjes së mandatit nga Kryetari i Komunës para një muaj e gjysëm, kanë ndodhur shumë vërshime, kanë ndodhur shumë vendime të Kryetarit të Komunës, shumë largime nga puna, shumë marrje e njerëzve në punë me projektin 'Kosova Med' dhe 'Caritas Kosova' dhe është dashur me marrë informata në lidhje me këto.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po më intereson të dijë nëse Migjeni ka folur në emër të Partisë Demokratike të Kosovës?

Asambleistët nga PDK-së: Sqaruan se ky është qëndrim i tërë Grupit tonë parlamentarë, andaj po.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: A don edhe dikush nga Partia Demokratike e Kosovës me marrë fjalën.

Asambleistët nga PDK-së: Jo.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Atëherë nëse nuk ka prej anëtarëve të Partisë Demokratike të Kosovës, të tjerët.

Bashkim Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë, për Kryetarin e Komunës, unë deshta me fol për pikën e katërt, në bazë të Udhëzimit Administrativ, nëse shkojmë në bazë të numrit të votave në zgjedhjet e fundit, të cilat kanë dalë, unë besoj që vendi para partive të tjera, është i katërti i Partisë Liberale Egjiptiane, edhe vendi në këtë komitet i takon Partisë Liberale Egjiptiane, kështu që unë kërkoj, që të respektohet udhëzimi administrative, siç e theksove, edhe vetë në fillim dhe besoj që na takon.

Ali Ismaili: I nderuari Kryetar i Komunës, z. Valon Prebreza, i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës z. Vlonjat Hasani, të nderuar përfaqësues të subjekteve politike, ju përshëndes të gjithëve ju uroj shëndet, mbarësi dhe të jetë, ky një fillim i mbarë që bashkarisht ta qojmë amanetin e qytetarëve të cilët na kanë votuar neve në vend me punë e përkushtim fillimisht, së dyti ata që nuk më njohin unë jam Ali Ismaili, është mandati im i katërt, mendoj që jemi dy-tre asambleistë në mandatin e katërt, jemi shumë pak, unë përfaqësoj një grup të qytetarëve të Fushë-Kosovës, por mbi të gjitha përfaqësoj vetëvetën, se skam ndonjë parti politike, jam me një iniciativë qytetare dhe si iniciativë qytetare, nuk kam marrëveshje politike me askënd, por po ju informoj që çdo herë në qoftë se vota e kësaj iniciative qytetare, i duhet këtij Kuvendi dhe e vlerësoj, që ajo pikë e rendit të ditës është në dobi të qytetarit, vota ime do të jetë për, në qoftë se e vlerësoj që një pikë është në dëm të qytetarit të Fushë-Kosovës, nuk e votoj, kështu që jam shumë komod në këtë pjesë, se sa pjesa juaj, që jeni. E vlerësoj pjesëmarrjen e Kryetarit të Komunës, për herë të parë pas shumë viteve, po merr pjesë një Kryetar i Komunës këtu, sepse nuk ka marrë pjesë shumë moti, unë dhe asambleistë të tjerë, që jemi në mandatin e katërt, kemi harruar kur ka marrë pjesë në një mbledhje Kryetar i Komunës, kështu që të përgëzoj kryetar, që jeni sot prezentë, është një punë e mbarë që po fillon, po shpresoj që edhe në të ardhmen, do të vazhdojë kështu. Sa i përket pikave të rendit të ditës Kryesues i Kuvendit të Komunës, në mbledhjen e parë që kam mbajtur para katër viteve i kam vendos 'Pyetjet dhe përgjigjet parlamentare', sepse është e vërtetë ajo që tha z. Laureati, në momentin që kemi postuar në rrjete sociale, personalisht i kam marrë tridhjetë e dy mesazhe private në mesenger që mundem t'i dëshmojë me emra, sepse kam marrë leje nga ata persona, që kanë disa pyetje, kryesisht janë shqetësime të qytetarëve me mbeturina, kanalizim e tjera. Do të ishte mirë që pyetjet dhe përgjigjet të ishin pjesë në rend dite, gjithsesi unë propozoj që të hidhet në votim, ne jemi që propozimi për pyetjet dhe përgjigjet parlamentare të jenë në këtë mbledhje. Vërejtje tjetër sa i përket Komitetit për Politikë dhe Financa, mendoj që është shumë mirë, sepse në materialin e parë, qysh na ka ardhë materiali ka qenë gabim dhe shumë mirë që keni reflektuar dhe keni sjellë materialin tjetër, ku sipas Udhëzimit Administrativ, duhet të jenë të përfaqësuara të gjitha subjektet politike, sepse këtu janë mësuar me domenin e numrave me arrogancës, kush i ka numrat me i vendos katër apo pesë anëtarë, herë hoxhën e shtina, herë e hjekum, herë e shtim Aleancën, atëherë Nismën, këtu kanë vepruar qysh kanë dashtë dhe mandej, kur e kanë dërguar atje në nivelin e vlerësimit, kanë intervenuar me telefonata dhe ta kanë kthyer përgjigjen, qysh kanë dashtë vetë, kështu që këtu ka qenë një hallakam dhe ishallah, kthehet mbarë dhe mendoj, që i keni kthyer mbarë Kryesues i Kuvendit të Komunës. Komiteti për Komunitete Bashkim, aty duhet me qenë t'i, sepse ju i përfaqëson komunitetet jo shumicë dhe tre anëtarë të komuniteteve, qoftë nga Lista Serbe, qoftë ju dy që jeni, unë nuk mundem me i përfaqësuar ma mirë se ju, për atë arsye ju shkoni andej, e na vijmë knej. Unë të përgëzoj Kryesues dhe do të mbështesim gjithëmonë, kur e shohim se t'i po punon drejtë dhe korrekt.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit z. Ali Ismaili, edhe për zotimin për mbështetje dhe po të garantoj, që kemi me punuar mirë dhe do të na mbështesësh gjithëmonë dhe gjithëmonë kemi nevojë për votën e të gjithëve. **Driton Ademi:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje, urime secilit për këtë mandat dhe punë të mbarë, unë pajtohem plotësisht, me këto pika të rendit të ditës, personalisht mendoj, se së pari duhet të konstituohen të gjitha organet e Kuvendit dhe me vepruar në mbajtjen e secilës pikë të rendit të ditës në vazhdimësi, është dashur të jenë edhe tjerat Komiteti për Komunitete dhe Komitetet tjera funksionale, sepse kështu funksionalizohet puna e Kuvendit. Mirë është të deklarohemi për ose kundër rendit të ditës, nuk është mirë të lëshohemi në përmbajtje në fillim, sepse kemi rastin me elaboru secilën pikë të ditës, pra përmbajtja e pikave të rendit të ditës, do të shtjellohen secila pikë veç e veç, pikat e rendit të ditës shtohen ose hiqen në bazë të Rregullores së Kuvendit, kështu që nuk ka pika statike, personalisht si Nismë Socialdemokrate, mendoj që 'Pyetjet dhe përgjigjet parlamentare' është pikë statike nuk parasheh ligji që gjithmonë duhet të jetë kjo pikë e rendit të ditës, kështu që unë pajtohem me përmbajtjen e këtij rendit të ditës.

Vildane Latifi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje, i nderuar Kryetar i Komunës dhe Kryesues i Kuvendit të Komunës, të nderuar/a koleg/e, ju uroj suksese në punë, subjekti jonë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, është për këtë rendit të ditës, duke pasur parasysh që është mbledhja e parë e Kuvendit të Komunës.

Ali Topalli: Përshëndetje të nderuar këshilltarë, i nderuar Kryetar i Komunës dhe Kryesues i Kuvendit të Komunës, te çështja e komuniteteve dha sqarimet Shefi i Grupit Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës, unë dua të fokusohem te rendi i ditës, te pjesa ku pashë pika të rendit të ditës, të cilat ka propozime nga drejtor të drejtorive, sinqerisht, unë nuk e di a kemi zyrtarisht drejtor në komunë, a keni informacion për këta drejtor, a është dashur të jetë pikë e rendit të ditës, që këta këshilltarë komunal ta kenë një informacion sa drejtori janë, kush janë, biografinë e tyre, kështu që po e vërejmë, se në pikat e rendit të ditës kemi propozime nga drejtor të cilët, unë nuk e di kush janë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar i kemi dy propozime që kanë ardhur nga asambleistët tanë, propozimi i parë për futjen në rendin e ditës është 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', po vazhdojmë me votim me ngritjen e dorës. Kush është për futjen e pikave të rendit të ditës në këtë mbledhje, në pikën e katërt të rendit të ditës, po e vendosim pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare'. Tani e qesim në votim.

U votua me unanimitet të votave nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, andaj konstatojmë se pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', aprovohet dhe hyn si pikë e katërt e rendit të ditës në mbledhjen e sotme. Propozimi i dytë është që pika e katërt e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, kush është 'Për' këtë propozim?

U votua me: nëntë vota 'për', njëmbëdhjetë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim.

Pas votimit Kryesues i Kuvendit të Komunës, konstatoj se ky propozim nuk kalon dhe pika e katërt e rendit të ditës zhvendoset dhe mbetet si pika pestë e rendit të ditës. Tani po e vendosim në tërësi të gjitha pikat e rendit të ditës në votim.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe shtatë abstenime, gjithsej njëzet e tre anëtarë pjesëmarrës në votim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoj që aprovohet rendi i ditës i propozuar me pikën shtesë 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare'.

Pika e parë (1) - Betimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani procesojmë me pikën e parë të rendit të ditës, duhet të formojmë një komision për verifikimin e mandateve, për anëtarët të cilët do të betohen sot. Komisioni përbëhet prej tre anëtarëve, një nga Lëvizja Vetëvendosje, një nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe një nga Partia Demokratike e Kosovës. Ju lutem tani të jepni propozimet e juaja për komision.

Kosovar Ademi: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje për anëtare të Komisionit për verifikimin e mandateve e propozojmë znj. Arlinda Mekolli.

Laureat Gojnovci: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës për anëtare të Komisionit për verifikimin e mandateve e propozojmë znj. Mirlinda Krasniqi.

Rrahim Tërnavaj: Në emër të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës për anëtare të Komisionit për verifikimin e mandateve e propozojmë znj. Dardane Sogojeva Shala.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: A jeni të gjithë dakort me këtë përbërje të Komisionit. U votua unanimitisht nga të pranishmit në mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Konstatoi se me votim unanimitisht formohet ky komision, atëherë anëtarët e propozuar për komision të dalin dhe t'i verifikojnë mandatet.

Ftoj në emër të komisionit znj. Arlinda Mekolli që ta merr fjalën.

Arlinda Mekolli: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, tani Komisioni verifikoi mandatet zgjedhore, në bazë të listës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të datës 27.12.2025, për anëtarin z. Dashnim Bajrami nga Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës dhe vendimin e datës 21.01.2026, për anëtarën znj. Saranda Sllamniku nga Lidhja Demokratike e Kosovës, andaj ne si komision konstatojmë, se janë plotësuar kushtet për leximin dhe nënshkrimin e deklaratave të betimit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, i ftoj anëtarët e rinjë që ta lexojnë deklaratën e betimit dhe ta nënshkruajnë atë në fund, dy anëtarët e rinjë ngrituni në këmbë ju lutëm dhe mund të filloni ta lexoni deklaratën e betimit duke e shprehur në fund edhe fjalën 'Beto hem'.

Saranda Sllamniku: Unë Saranda Sllamniku deklaroj solemnisht se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtare e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë. 'Beto hem'.

Dashnim Bajrami: Unë Dashnim Bajrami deklaroj solemnisht se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë. 'Beto hem'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Urime znj. Saranda Sllamniku dhe z. Dashnim Bajrami, suksese dhe punë të mbarë, prej këtij momenti dy anëtarët e rinjë janë zyrtarisht anëtarë të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, duke e përbushur numrin prej tridhjetë e një anëtarëve.

Pika e dytë (9) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, datë 04.12.2025.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: A ka dikush diçka të diskutojë rreth përmbajtjes së këtij procesverbali, nëse jo atëherë po e hedhim në votim 'Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja

Inauguruese e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, datë 04.12.2025.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej tridhjetë e një anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votive të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, aporovohet 'Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja Inauguruese e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 04.12.2025.

Pika e tretë (3) - Propozim për emërimin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e ftojme Kryetarin e Komunës z. Valon Prebreza që ta merr fjalën.

Kryetari i Komunës: Përshëndetje për të gjithë, sidomos për asambleistat e rinjë punë të mbarë. Të nderuar të pranishëm mbështetur në nenin 61 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenet 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal Nr. 03/2023 për procedurën të emërimit të Nënkyetarit të Komunës për Komunitete, pas konsultimeve paraprake me të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në Komunën e Fushë-Kosovës, të cilat i kam mbajtur me datën 12.01.2026, i propozojë Kuvendit të Komunës, që të marrë vendim për emërimin e z. Gëzim Gara me vendbanim në Fushë-Kosovë, përfaqësues i komunitetit ashkali në pozitën e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete për mandatin zgjedhor 2025-2029, detyrat dhe përgjegjësitë e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete, burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2023 dhe Statuti i Komunës së Fushë-Kosovës. Kërkojmë aprovimin tuaj.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë kryetar, sa për sqarim përveç shumicës së thejështë, në këtë rast nevojitet edhe vota e dyfishtë, ose prej tre anëtarëve të cilët janë përfaqësues të komuniteteve në Kuvendin e Komunës, shumica e tyre duhet të votojnë për këtë propozim të Kryetarit të Komunës. A ka dikush diçka të shtojë rreth këtij propozimi? Po vazhdojmë me Lëvizjen Vetëvendosje.

Kosovar Ademi: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, pajtohet që propozimi i Kryetarit të Komunës të aprovohet.

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues, znj. Saranda Sllamniku dhe z. Dashnim Bajrami urime ju priftë e mbara, sa i përket pikës së rendit të ditës propozimi i emërimit të Nënkyetarit për Komunitete, kryetari propozoi z. Gëzim Garën dhe citoi nenin 61 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ku thotë që 'Në komunat ku të paktën 10% e qytetarëve i përkasin komuniteteve jo shumicë duhet ta kenë një Nënkyetar për komunitete', nga regjistrimi i fundit e dimë që në Komunën e Fushë-Kosovës, komunitetet jo shumicë nuk e kanë mbërrirë 10%, që do të thotë, se thirrje në nenin 61 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale duhet të bien poshtë, pastaj udhëzimi administrativ e lejon një hapësirë që është në vullnetin e një kryetari me i propozuar Kuvendit të Komunës për emërim një Nënkyetar për Komunitete, por thotë duke i rishikuar mundësitë financiare, unë mendoj që duhet të na tregojnë, a'i kanë rishikuar mundësitë financiare, cilat janë mundësitë financiare dhe u thirrë edhe në nenin 7 të udhëzimit administrative, por unë mendoj se ky nen është shkel, sepse ky nen thotë jo më larg se 30 ditë prej betimit të Kryetarit të Komunës duhet me propozuar, nuk ka pasur vullnet brenda 30 ditëve prej betimit të Kryetarit të Komunës, nëse dojmë me u thirrë në udhëzimin administrative, thirruni në tërësi edhe tek neni 5, edhe te neni 6, edhe te neni 7. Nëse ky vendim ka me shkuar në Ministri për shqyrtim, unë dyshoj që do të kthehet z. Gëzim Gara dhe kjo është, sa me pastruar atë marrëveshjen, që e keni bërë gjatë zgjedhjeve lokale që ty me të thënë, që të

kemi propozuar për Nënkyetar për Komunitete, po ministria nuk e ka pranuar, sepse thotë e keni shkel udhëzimin administrativ. Edhe njëherë po them se udhëzimi administrativ është shumë i qartë, neni 5 i a lejon kryetarit me propozuar këtë, por nëse sot e votojmë atëherë jemi duke shkel nenin 7 të udhëzimit administrative, kështu që unë ju bëj thirrje si për pikën e Komitetit për Politikë e Financa, që mos me qitë në lajthitje, as këtë Kuvend, e as kandidatin për Nënkyetar nga radhët e komuniteteve, kërkoni sqarim nga Ministria, nëse nuk e kemi bërë brenda 30 ditëve, a na lejohet kurdo që ne dëshirojmë me propozuar para Kuvendit të Komunës një Nënkyetar për Komunitete. Ligjërisht Komunës së Fushë-Kosovës, nuk i takon me pasur një Nënkyetar për Komunitete, sipas udhëzimit administrativ po, por duke e respektuar të gjitha nenet e udhëzimit administrativ.

Driton Ademi: Përparësi në rastin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete, kanë dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale sipas hirarkisë së akteve juridike.

Aida Alimi: Përshëndetje i nderuar Kryetar i Komunës dhe Kryesues i Kuvendit të Komunës, anëtarë të Kuvendit urime, uroj që të na shkojë mbarë puna në këtë Kuvend, të nderuar të pranishëm, unë kërkoh një sqarim nga juristi pasi që është këtu i pranishëm, të na tregoj saktë, se a thotë ligji dhe rregullorja dhe a është e drejtë, kjo që na është ofruar për të votuar këtë mandat.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit Aida, dikush tjetër prej kolegëve asambleistë. Jo, atëherë sa për sqarim ndaj kolegut z. Laureat Gojnovci thirrja në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, duhet të bëhet për arsye të procedurave të zgjedhjes, ndërsa përfaqësuesit ligjor mund të ju drejtoheni me shkrim, sepse këtu në Kuvend nuk ka të drejtë fjale, sepse nuk është anëtar i zgjedhur i Kuvendit. Atëherë sipas përshkrimit dhe materialit, që ka ardhë thirrje në këtë ligj dhe udhëzimin administrativ, është për arsye të procedurave të zgjedhjes, nëse nuk ka dikush tjetër diçka me shtuar në këtë pikë të rendit të ditës, atëherë vazhdojmë me hedhjen në votim, të Propozimit të Kryetarit z. Valon Prebreza për emërimin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me votimin e dyfishtë, Propozimi i Kryetarit të Komunës për emërimin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete, aprovohet dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 27, të datës 12.01.2026, për emërimin e z. Gëzim Gara i lindur më datë 30.08.1978, me vendbanim në Fushë-Kosovë, përfaqësues nga Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës - dega në Fushë-Kosovës, në pozitën e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës në mandatin zgjedhor 2025-2029.
2. I emëruari në pozitën e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, të drejtat dhe përgjegjësitë e tij, do të fillon t'i ushtron nga dita e emërimit të tij nga data 22.01.2026, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Nënkyetarit të Komunës për Komunitete z. Gëzim Gara, i urojmë sukses dhe punë të mbarë.

Pika e katërt (4) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Vazhdojmë me pikën e katërt e rendit të ditës, pyetje dhe përgjigje parlamentare, ju lutem të paraqiteni kush ka pyetje parlamentare.

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues, unë parimisht e respektoj, çdo vendim dhe e uroj Nënkryetarin e Komunës për Komunitete z. Gëzim Garën, por shpresoj që Ministria mos të bjen një vendim me të cilin duhet të shfuqizohet ky vendim dhe t'i me vazhduar me qenë Nënkryetar për Komunitete. Le të themi që u zbatua në tërësi udhëzimi administrative, por Nënkryetari i Komunës për Komunitete, duhet me e përfaqësuar, një barazi mes komuniteteve jo shumicë në Fushë-Kosovë. Nje pyetje tjetër e kam për Kryetarin e Komunës, se a përfaqëson në mënyrë të barabartë z. Gëzim Gara, komunitetet jo shumicë në Fushë- Kosovë, pasi që e dimë që ekziston një subjekt tjetër që është Partia Liberale Egjiptiane, si partia që është ma e madhja e komunitetit jo shumicë dhe ka mbetur e pa përfaqësuar brenda këtij objekti, si institucion i Komunës së Fushë-Kosovës, unë sot bëjë pyetje kush janë Drejtorët Komunal të Fushë-Kosovës, sa drejtori i kemi, a është bërë harmonizimi i rregullores për harmonizimin e vendeve të punës dhe organogramit të komunës, sa këshilltarë i ka Kryetari i Komunës, mbi cilën bazë janë emëruar ata këshilltarë. Na jemi ballafaquar me një situatë të vërshimeve, e cila në Komunën e Fushë-Kosovës, ka qenë një prej komunave më të prekura në nivel vendi, edhe sa i përket menaxhimit, cilët hapa i ka marrë Kryetari i Komunës, së bashku me drejtorët, sidomos drejtorët e linjës Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, sa familje kanë arritë me ju dal në ndihmë pa u bërë thirrje për vlerësimin e dëmëve, që u bo nga vërshimet, unë e di që keni bërë një hap, ju ka ardhë një donacion i bidonave me ujë dhe keni shpërndarë ujë bashkë me asambleistë, qytetarët të cilët kanë pasur mungesë uji është dashtë me pritur një drejtor ose një asambleistë me i thënë, hajde se po ta jepi një bidon ujë, kur ai mundet me marrë vetë. Një pyetje e kam për Drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ka ardhë një Auto-ambulancë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe po du me ju pyet kur kanë filluar procedurat e atij projekti, kush i ka zhvilluar procedurat, po ashtu e keni bërë një lajm, që e keni marrë një infermiere, e keni dërguar në fshatin Bardh i Madh, ndërsa e keni anuluar konkursin për infermier dhe doktor ne Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, këto janë pyetjet për fillim, uroj që të bëni punë të mira dhe do të keni lavdatat tona, por kur kemi paqartësi dhe pakënaqësi normal që do t'i shprehim këtu.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Për secilin pyetje veç e veç Kryetari i Komunës, do të jep përgjigje, pastaj vazhdojmë me të tjerët.

Kryetari i Komunës: Përgjigjia për z. Laureat Gojnovci dhe z. Ali Topallin, që thatë se nuk po i njihni drejtorat, unë më shumë se gjysmën e administratës në komunë, nuk i njoh, sepse nuk janë banorë të Fushë-Kosovës, drejtorat e mi mundeni mi njoftë menjëherë në bazë të mbiemrave p.sh mbiemri Kelmendi është i Fushë-Kosovës, unë drejtorat e mi nuk i kam sjellë prej Pejës, Prizrenit, Suharekës, Ferizajit e tjera, janë të gjithë kojshi tanë, lehtë e keni me i njoftuar. Sa i përket vërshimeve po besoj që keni qenë i informuar, që unë dhe stafi im, shtabi emergjentë kanë qenë të angazhuar maksimalisht me mundësitë që kemi pasur, partia jote e ka lënë komunën me një eskavator, turp duhet të ju vijë me bërë pyetje për vërshime, fshatin tënd e keni lejuar te ura e Lismirit, me shkuar kompanitë e ndërtimit me hedh dhe, aty dheu I hedhur shkakton probleme, e merrë uji fshatin tënd. Konkursi i fundit që është shpall në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, ka qenë jashta linjës buxhetore, konkursi është shpall për 44 pozita, ndërsa të lejuara me buxhet kanë qenë vetëm 24 pozita, do të thotë 20 pozita më shumë për qëllime elektorale, ju

jeni mësuar që në Administratën e Komunës, punëtorët e arsimit edhe punëtorët e shëndetësisë, me ardhë në derë për punë, kjo me neve nuk do të ndodhë, e kemi anuluar tani, do të shpallim të riun dhe do të marrin punëtorë, aq sa ka linjë buxhetore. Harmonizimin e rregullores këtë do ta bëjmë bashkarisht me juve, drejtorja janë aq sa i keni lënë ju, aq i kemi emëruar edhe ne, në bazë të gjendjes, që e keni lënë këtu, kemi me vazhduar me harmonizim kërkojmë bashkëpunimin e juaj.

Laureat Gojnovci: Faleminderit kryesues, kryetar unë pyetje bona dhe kjo çasje, besoj që nuk të kontribon, as ty, as institucionit të cilin e drejton, po bëjë pyetje elementare dhe të thjeshta, nuk po me intereson, a janë te Pejës ose Gjakovës, çka përfaqësojnë këta drejtor komunal kjo është pyetja ime, sepse unë e di që z. Mirsadi është i Bardhit të Madh, por të tjerët i njoh shumë pak vetëm si emra, mos e merrni personale nuk po e kontestoj se nga janë. Sa i përket Administratës në komunë nuk jemi ne përgjegjës nëse ka ndonjë gjë, nëse ka diçka që ju e keni vlerësuar dhe konstatuar, që janë bërë shkelje dërgoni në vendin kompetent, nuk mundesh me mu drejtuar mua, se e kam bllokuar fshatin dhe e ka marrë uji, sepse unë po them Kryetar në frymën e bashkëpunimit, që ky Kuvend të funksionoj mirë kjo çasje nuk i kontribuon, ju lutem që të jeni më transparent dhe më komunikues me anëtarët e Kuvendit të Komunës, une nuk hyra në personale me drejtorja, me kryetarin e as nënkryetarin thjeshtë, bëra pyetje dhe meritojmë si asambleistë komunal me pas një përgjigje.

Kryetari i Komunës: Nuk e kam obligim me t'i treguar ty drejtorët, a'i njeh apo jo kjo është çështje irrelevante për mua, nëse dëshiron mundesh t'i takosh dhe të njoftohesh me ta për ndryshe të gjitha vendimet janë publike dhe prezantimi i drejtorëve, do të bëhet në ueb-faqe të komunës për secilin drejtor, në cilin pozitë, është kështu që pyetje keni drejtë me bërë, sa i përket fshatit tënd, këtu keni qenë edhe në mandatin e kaluar dhe hedhja e dheut, ka ndodhë në kohën kur keni qenë këtu.

Aida Alimi: Faleminderit i nderuar kryesues, unë i kam dy pyetje. Kur do të jenë funksional mikrofonët, që ne të kemi mundësi të diskutojmë nga vendi dhe të mos dalim për çdo gjë këtu në foltore, po ashtu edhe një kërkesë tjetër është se kërkojë që materiali të na vijë në formë fizike.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit Aida, synimi jonë është që transparenca të jetë në nivelin më të lartë, mikrofonët shumë shpejtë do të rregullohen, kemi tentuar që t'i rregullojmë për këtë mbledhje, por për arsye të problemeve teknike dhe disa vështirësive të tjera, që i kemi trashëguar nga pushteti i kaluar na është pamundësuar kjo, kemi plane edhe për zgjerimin e sallës së Kuvendit dhe për materialin e Kuvendit, normalisht e tëra që është brenda rregullave dhe procedurave, do të ju shpërndahet me kohë.

Migjen Kolshi: Faleminderit kryesues, unë deshta rreth vërshimeve e keni formuar një komision për vlerësimin e dëmeve, çka ka bërë deri tash ai komision dhe një pyetje për kryetarin. Kryetar gjatë fushatës i keni dhënë disa premtime, të cilat në start nuk i keni realizuar, premtimi i parë është Nënkryetari me qenë femër dhe 50% e drejtorive me qenë të drejtuara nga gratë, kjo nuk ka ndodhur, pyetje tjetër, monitori i komunës, a është për shërbime të komunës me u përdorë apo për shërbime partiake, sepse dy muaj pas zgjedhjeve ka qenë llogoja e Lëvizjes Vetëvendosje, së bashku me kandidatin për kryeministër dhe deputetin e Fushë-Kosovës. Sa ka qenë numri i të punësuarve, kur jeni ardhë me Kosova Med dhe sa është tani?

Ali Ismaili: I nderuar kryetar, kryesues, fillimisht i falenderoj të gjithë asambleistët, që e aprovuat propozimin tim, e futëm pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare' në rend të ditës, së dyti kryetar

është mirë mos me hi në gjynah me neve se ne jemi mësuar 25 vite me qenë një drejtor, por mendoj që një CV e drejtorëve ne ueb-faqe është mirë në të ardhmen me i vendos, sepse e vlerësoj, pastaj kam një pyetje prej një qytetari, a ka mundësi me hedh nga një CV drejtorët? Është mirë me pasur. Kryesues të përgëzoj, unë për katër vite nuk kam mundur t'i rregulloj mikrofonët, sepse nuk ka pas vullnet politikë për asgjë, e kemi sot një vendim për ta shfuqizuar të cilin e ka kthyer Ministria dhe ju me të drejtë e keni shfuqizuar, sepse ai vendim për marrjen e atyre punëtorëve në shëndetësi, ka qenë i kundërligjshëm dhe janë 40 vetë, është vendim i Kuvendit të cilin unë e kam nënshkruar dhe e kam tërheq paralelen, që është i kundërligjshëm por megjithatë ka vazhduar ky vendim. Është herët për disa pyetje por me qenë korrekt me qytetarë, po mundohem të bëjë dy-tre pyetje shpejt e shpejt në dobi të qytetarëve. Një nga pyetjet që kam marrë nga qytetarët, është të lutem pyete kryetarin, a ka me ndërmarrë masa se na mbyti papastërtia në qytet? Një tjetër pyetje, është ku një qytetarë thotë banojë në rrugen 'Epiri' aty ku fillon rruga 'Isa Boletini' dhe thotë se nuk po mundemi me nejt nga aroma shumë e keqe, një biznesmen pyet, a ka mundësi me bërë një rregullore, ku ne që kemi biznese ose lokale mbi bazën e asaj rregullore me na lejuar me paguar në komunë, një taksë për ngarkim-shkarkim e mallit para lokalit. Një qytetarë tjetër nga diaspora thotë, ju lutem kryetar dhe kryesues me bërë një transmetim drejtëpërdrejtë, me parë se çka po flitet në Kuvendin e Komunës, nuk po e zgjas me shumë sa i përket pyetjeve, vetëm një sqarim: E falenderojë organizatën 'Bereqeti' të Bashkësisë Islame, e cila ka bërë një punë të jashtëzakonshme gjatë vërshimeve, e falenderojë drejtorin të cilin nuk e njoh, që ka marrë ata ujë edhe atë donator që e ka dhënë ata ujë dhe të gjithë të tjerët, që kanë kontribuar duke përfshirë kryetarin, kryesuesin dhe nënkryetarin, që kanë qenë 24 orë të qasshëm.

Bashkim Krasniqi: Faleminderit kryesues, i nderuari kryetar, të nderuar asambleistë mbasi po dal për herë të parë këtu po prezantohem jam Bashkim Krasniqi - kryetar i Partisë Liberale Egjiptiane dhe jam këtu, për të mbrojtur interesat e qytetarëve në përgjithësi e posaçërisht të komunitetit egjiptian. I nderuar kryetar, unë po të falenderojë për vendimin që e ke marrë, për zgjedhjen e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete, sepse pavarësisht ndarjeve tona politike, komunitetet nuk kanë nevojë me i pasur këto dallime, sepse kanë nevojë për një nënkryetar për t'i përfaqësuar në komunë, mirëpo ndoshta lindë pyetja pse Bashkim po më falenderon, që e kam bërë këtë gjestë? Po të falenderojë, sepse është dashur të bëhet një nënkryetar por atëherë mund të thuhet, pse votove kundër? Kryesuesi tha vetëm kush është 'Për', por nuk pyeti kush është 'Kundër', sepse personi për mua dhe po besoj për një numër të madh të qytetarëve të komuniteteve, nuk janë të pajtimit që ai nënkryetar të jetë, sepse nuk e ka nivelin e duhur arsimorë, por mbi të gjitha kryetar po të tregojë, se qysh në javën e parë ka keqë përdorë shpërndarjen e druve, që kanë qenë të destinuara për personat që kanë pësuar dëme gjatë vërshimeve, sepse ju ka thënë votuesve të mi, nuk ju jap drutë, sepse e keni votuar Bashkim Krasniqin, kjo është arsyeja pse unë nuk e kam votuar. Në legjislaturën e kaluar ne nuk kemi pasur Nënkyetarin për Komunitete për dy vite për arsye të kësaj partie, mirëpo unë nuk e bëjë këtë. Po e falenderoj kryetarin për krejtë, çka ka bërë, mirëpo personi që është zgjedh nënkryetar jam i bindur, se do të zhgënjej edhe kryetarin, sepse drutë janë dhënë për banorët e Fushë-Kosovës, të cilët janë kapluar nga vërshimet jo me ja dërguar mikut të tij në fshatin Henc, ndërsa njerëzit që e kanë votuar Bashkimin nuk kanë marrë dru, edhe pse i kanë marrë vërshimet. Kjo është arsyeja pse unë nuk pajtohëm me këtë. Faleminderit dhe çdoherë që ka punë të mira për komunitetin, unë jam këtu dhe ju përgëzoj.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndetje për të gjithë, deshta të bëjë një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike, rruga 'Fehmi Lladrovci' dhe 'Rasim Kicina', kanë telashe me ujërat e zeza dhe mbyllje e tyre, kështu që të lutem drejtor një numër kontaktues me na dërgu neve, sepse të kam shënuar por s'më jeni përgjigjë. Pyetjet e banorëve të Sllatinës, Bardhit, Miradisë edhe të Fushë-Kosovës, kush e merr përgjegjësinë për mbeturina, pasi që një javë nuk ka vazhduar askush për t'i larguar. Drejtoreshën e Shëndetësisë dua ta pyes tek pika 15 e rendit të ditës, kërkojnë qytetarët e Fushë-Kosovës që janë banorë, por nuk kanë leje qëndrime të Kosovës, nga Medvegja, Bujanoc e Preshevë, që edhe ata të jenë me grupin 1 euro pagesë, e jo 5 euro, janë për 25 vite banorë dhe është çështje e pa zgjedhur e tyre, kisha dashur edhe ata të jenë të liruar nga kjo pagesë. Drejtori i Arsimit, e kam një pyetje pse nuk jeni përgaditur me kohë për të filluar mësimi, por ka pasur telashe me furnizimin e ngrohjeve nëpër shkolla dhe këto orët e humbura, a do të zëvendësohen në ditët në vijim, a keni bërë ndonjë planifikim a jo?

Dashnim Bajrami: Përshëndetje kryetar, përshëndetje kryesues, përshëndetje koleg/e asambleistë vetëm një replikë të shkurtë ndaj Bashkim Krasniqit dhe juve opinionit, ne sapo jemi zgjedhur për komunitete dhe nuk do të jetë si në të kaluarën, besoj se Nënkryetari z. Gëzim Gara, do të bëjë një ndryshim të madh në lagjet e komunitetit tonë, përndryshe i përfaqësojmë 3.224 ashkali, janë 800 egjiptian dhe 300 romë sipas Entit të Statistikave të vitit 2024, e përgëzoj z. Gëzim Garën për pozitën e re dhe ju premtoj që në emër të komunitetit ashkali, nuk do të bëjmë dallime se a është romë, ashkali apo egjiptian, jemi njerëz dhe nuk do të bëjmë ndarje dhe do të punojmë fortë, besoj që kryetari do të përkrah komunitetin tonë pa dallim, sa i përket vërshimeve e falenderoj kryetarin, që ka ndër marrë hapa më të mirë deri më tani, duke i vizituar dhe ndihmuar qytetarët.

Bashkim Krasniqi: Faleminderit Dashnim, që po e pranon që 20 vjet, ju e dini kush ka qenë 20 vjet, nuk dua me hy në replika por na bashkë kemi me punu Dashnim, për t'i përfaqësuar komunitetet dhe kretjtë qytetarët e Fushë-Kosovës, nëse flasim për 20 vjet e kaluara t'i ki bagazh më shumë se unë.

Valon Murseli: Përshëndetje kryesues, përshëndetje për të gjithë kolegët, disa nga shqetësimet që kam marrë nga qytetarët e Fushë-Kosovës, është ngastra kadastrale ngjitur me objektet e 'Britania Home' në rrugën '28 Nëntori', ku janë të vendosura disa garazha, që mendoj se janë të jashtëligjshme në një objekt, që ka qenë më herët dhe kërkojë që të shikohet nga Drejtoria e Inspektoriatit, se cilat veprime mund të merren në atë ngastër kadastrale, të lirohet ajo ngastër kadastrale, të krijohet një zonë parking e mirë dhe një pjesë e hapsirës të shfrytëzohet, për kënd lodrash pasi që është shumë e nevojshme. Investimet në rrugën 'Salih Puqolli', që ka një gjatësi rreth 150 metra, të cilën e kaloj vetë si pjesë të stafit të Hekurudhave 'Train-Kos' Sh.A, kërkoj që të shikohen mundësitë financiare, pasi që nuk ka kosto të lartë, që të intervenohet në këtë rrugë po ashtu në rrugën '28 Nëntori', të shikohet mundësia e intervenimit në trotuare, pasi kalojnë shumë nxënës të shkollës 'Mihal Grameno' - Aneksi 3, nuk ka kosto të lartë besoj, është më gjatësi 100 metra, besoj është e nevojshme të rregullohet trotuari në të dy anët e kësaj rruge. Kemi ankesa nga shumë biznese, që trajtimi nuk është bërë një trajtim i duhur nga qeverisja e kaluar, nuk është intervenuar në shumë raste, besoj që Drejtoria e Inspektoriatit mundet me intervenuar. Tek vlerësimi i dëmeve kërkoj që të ketë një vlerësim sa më korrekt, po ashtu të krijohet një masterplan nga profesionist të komunës, ose të angazhohet një Kompani konsulente me profesionist të caktuar për të marrë masa preventive, që të mos vijë deri te këto dëme.

Ali Topalli: Tani z. kryetar ashtu siç ju e përfaqësoni elektoratin e juaj, edhe ne kemi elektoratin tonë dhe shprehim shqetësimet tona, kërkesat tona dhe pyetjet tona. Sinqerisht unë nuk e prita atë reagim, duke pasur parasysh pozicionin e juaj, por ndoshta edhe pak nga përvoja si do që të jetë, unë po ta jap sugjerim reagimin që patët më herët nga pozita e kryetarit unë nuk do ta lakmoja. Sa i përket çështjes së drejtorëve, unë nuk kërkoja prej cilit regjion vijmë, as cilit subjekt politikë i takojmë, as çka përfaqësojmë është çështje e juaja, por bashkëpartiakët tu çdo herë kur kemi pasur mbledhje, e parë gjithmonë kanë kërkuar ta dinë kabinetin e kryetarit, ashtu siç e tha edhe Shefi i Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kështu që nuk kërkoja sqarime për asnjë drejtor, çdo respekt për ata që i njoh dhe ata që si njoh, punë të mbarë dhe do të keni mbështetjen tonë, por kryetar ne jemi këtu, sepse edhe bashkëpartiakët e tu kanë qenë në opozitë dhe për katër vite do të bëjmë pyetje, kujdesu për reagimet e tua, për imazhin tënd, sepse unë nuk jam këtu për të mësuar ty, por ne për katër vite do të bëjmë pyetje dhe do të jemi opozitë e vërtetë dhe funksionale.

Kryetari i Komunës: Unë nuk përfaqësoj elektoratin tem përfaqësoj qytetarët e Fushë-Kosovës, fushata është kryer nuk jemi këtu për të përfaqësuar një grup të caktuar, i nderuar Ali, sa i përket drejtorave tash e pasthë në ueb-faqe vetëm dy drejtor nuk e kanë CV-në, të paraqitur në ueb-faqe të komunës.

Nënkryetari i Komunës: Faleminderit shumë kryesues, të nderuar të pranishëm, i nderuar Kryetar i Komunës z. Valon Prebreza, dua të reagoj nga kjo e fundit, duhet ta kemi të qartë se ne nuk përfaqësojmë grupacione të vogla, ne përfaqësojmë qytetarët e Fushë-Kosovës, nashta edhe t'i nuk e keni përvojën i nderuar z. Ali Topalli, jeni mësuar të përfaqësosh grupe të vogla, këtu përfaqësojmë krejtë qytetin e Fushë -Kosovës, grupi i juaj është zvogëluar gjithmonë, kurse ne jemi rritë, por gjithsesi ne i përfaqësojmë të gjithë qytetarët e Fushë-Kosovës pa dallim, po besoj që ky është dallimi më i madh, që e kemi ne me ju. Ndyshimi tjetër që ka ndodhë është ta kemi Kryetarin e Komunës në mbledhje, gjë që nuk ka ndodhë më herët, sepse unë, edhe t'i kemi, qenë 4 vite këtu dhe nuk e kemi parë asnjëherë, nuk ka qenë i interesuar me na dëgjuar, as juve, as neve, ky është dallim i madh. Unë nuk e kuptoj ku kemi ne obligim, me ju tregu juve kush janë drejtorët, unë do të ndjehesha i lumtur, nëse ne kishim diskutuar, nëse një drejtor i joni nuk po punon mirë, nëse një drejtor i joni nuk është i qasshëm për qytetarë, ose për juve si asambleistë, sepse ju bartni kërkesa të qytetarëve, nëse keni vërejtje te një drejtor, që keni pas kërkesë dhe nuk ju ka përgjigjë atëherë flasim, unë e di që ajo zonja ka qenë Drejtore e Bujqësisë, nuk e njoh dhe nuk kam shpreh interesim kurrë për ta njohur më shumë, nëse kisha dashtë me njoftë një drejtor, ju kisha drejtuar vetë, ne nuk e kemi obligim për të ju njoftuar me drejtor, sikurse ju që nuk e keni pas më herët. Nëse hyn në ueb-faqe i sheh drejtorët dhe ueb-faqet kanë filluar të funksionojnë më mirë, këtu një pjesë e konsiderueshme e stafit, nuk e dinë për çka janë në komunë, e dine gojarisht po detyrën nuk e dinë saktësisht, kemi pasur infermier që ka punuar në administratë, këtu ka pasur gjithë çka dhe ende ka, edhe përvojën që e keni pasur atëherë nuk e keni ditë që infermierët janë për Qendrën Shëndetësore, jo për Administratë. Ju z. Ali, me sa e di unë jeni marrë me kulturë, gjendja është e mjerueshme në Shtëpinë e Kulturës në Komunën e Fushë-Kosovës, aktiviteti kulturor në komunë është zero, edhe ende merrni guximin me fol për kulturë është mirë secili me mirëkuptuar njëri tjetrin dhe me bërë një diskutim thelbësor, për atë se çka mundemi me përmirësuar jetën e qytetarëve të Fushë-Kosovës, çështja më substanciale ishte prej asambleistit z. Valon Murseli, që tha qysh me rregullë ujin, që mos të na merr vitin tjetër dhe këtë diskutim, duhet me bërë, se sa

herë bjen shi na kemi vërshime, kjo është çështje, që duhet me diskutuar, që kur bjen shi të mos na marrin vërshimet.

Ali Topalli: Unë nuk kërkoja asnjë sqarim nga Nënkrjetari i Komunës, unë ju drejtova Kryetarit të Komunës, por pse doli në foltore është çështje e tij. E dyta nuk e patum asnjë pyetje në fushën e kulturës, kurdo që do t'i kemi ato, ne do të jemi këtu, u drejtuat në foltore për kulturën, kur jemi te pyetjet dhe përgjigjet parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Sa për sqarim z. Ali Topalli, Nënkrjetari në vazhden e përgjigjeve dhe diskutimit e përmendi dhe kulturën, sepse ka qenë në fushën tuaj mandatin e kaluar, kështu që nuk ka asgjë të keqe.

Jetmir Berisha: I nderuar kryetar, kryesues, asambleistë dhe të gjithë të pranishëm në sallë, uroj që të jetë një mandat i sukseshëm me nje bashkëpunim për të mirën e qytetarëve, tanë t'i finalizojmë projektet në interes të përgjithshëm. Unë jam në mandatin e tretë dhe Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, është shembull në të gjithë Kosovën për respekt, transparencë mes kolegëve në sallë dhe i përgëzoi të gjithë. Aliu dhe Migjeni janë një mandat para meje dhe besoj të vazhdoj ajo frymë e bashkëpunimit, respektit, komunikimit dhe e drejtës së lirë për të pyetur, për të kërkuar sqarim, për të përkrahur kur është në interes të qytetarëve dhe në asnjë moment të mos sulmohet ose ndalet fjala e lirë, kërkesa e asambleistit i cili është zë i qytetarit të Fushë-Kosovës. Kam respekt për kolegët nga e kaluara të veçantë për ta, përfaqësimi politikë është në domenin e secilës parti dhe i përfaqësojnë interesat e secilit subjekt politikë, qytetarët kanë vendosur që kësaj here të jeni ju në pushtet.

Ali Ismaili: Edhe ju, edhe Nënkrjetari i Komunës, deri tash ders po na mani, bone pyetjen dhe përgjigjen dhe ecim prej shpie.

Jetmir Berisha: Ligji na ka caktuar secili ku të ulet, në këtë rast është Kryesuesi i Kuvendit që ma jep fjalën, ma tregon kohën e cila më takon. Për 8 vite tash i 9-ti, asnjëherë nuk ka ndodhur ta ndërpresë dikën, kur ka qenë në foltore dhe nuk do të ndodhë, është parim edhe jeni Hoxhë, respekt duhet të na dëgjosh, sepse keni një mesazh i qartë për gjithë shoqërinë dhe grupet politike këtu. Pyetje është vërshimet që kanë ndodhur, komisioni që është krijuar për vlersimin e dëmeve, sa ka arritur të bëjë vlerësim të dëmeve, të vizitoj familjet të cilat kanë dëme dhe kërkoj që të mirren në prioritet ato familje, që kanë pasur dëme më të mëdha dhe ato familje të kthehen në shtëpitë e tyre dhe të fillon jeta normale për ta.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit Jetmir, dikush tjetër nuk ka të bëjë pyetje, prej momentin që fillojmë të japim përgjigje nuk marrim pyetje të tjera, ata që kanë pyetje shtesë mund të drejtohen me shkrim në drejtorinë e caktuar ose organet relevante. Më kujtoi Hasani se mungon pyetja për rrugën 'Lumi', nuk e kemi harruar rrugën 'Lumi', e kemi në mendje dhe do të përkujdesemi për të. Një përgjigje deshta t'i jap kolegut z. Ali Ismaili, është hap një link në youtube, në të cilin do të bëhet transmetimi i mbledhjeve live, jo në këtë mbledhje, por prej mbledhjes së ardhshme, transparenca do të jetë gjithëmonë e gatshme për qytetarë. Prej pyetjeve që janë parashtruar nga kolegët tanë, a ka dikush prej drejtorëve, që dëshiron të jap përgjigje të drejtëpërdrejtë, nëse po ngriteni dorën ju lutem.

Durim Hajra: Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, asambleistë shfrytëzoj rastin të ju uroj punë të mbarë sidomos dy asamblesitëve të rinjë dhe nënkryetarit për komunitete. I kërkoj falje asambleistit që parashtroi pyetjen, sepse unë nuk isha në atë momentë në sallë të Kuvendit për arsye të angazhimeve në zyre, pyetja kishte të bëjë me lirim e hapësirave publike, besoj se jeni

të informuar se Inspektoriat i është në terren dhe po vazhdon me një vendim të Kryetarit të Komunës, që ka qenë në mandatin e kaluar, sa i përket rrënimit 'Kontrata për rrënim është shpenzuar dhe jemi duke pritur procedurat e prokurimit për kontraktimin e një operatori të ri. Ju bëj thirrje qytetarëve dhe bizneseve që kanë ankesa, se një pjesë ju është rrënuar terasa ose hapësira para bizneseve, ky aksion do të vazhdojë në tërë territorin e komunës së Fushë-Kosovës. Hapësirat publike që i kemi trajtuar me prioritet nga këndi i opozitës, do t'i trajtojmë me prioritet dhe nga këndi i pozitës, do të vazhdojmë deri në lirimin e të gjitha hapësirave publike, fillimisht jemi duke shkuar me njoftime, vërejtje dhe procedura tjera, ndërsa në momentin që e kemi kontratën do vazhdojmë me rrënim në qytet, duke mos përjashtuar fshatrat. Një informatë tjetër, edhe objektet që janë në tejkalim të lejes, do të merren masa administrative deri në ndalim të punimeve, derisa të kthehet ligji në vend. Ndërsa për pyetjen tjetër, me informacionin që e kemi nga Drejtoria e Planifikimit Urban, vendi ku janë të vendosura ato garazha del se janë prona private, dy janë në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore, ndërsa një është e komunës, derisa nuk kemi kontratë rrënimi nuk mundemi mi largu ato objekte, vërejtja ju është dhënë ose të prezantohet leja për to. Edhe ato garazha dhe çdo objekt tjetër, që është i vendosur pa pëlqim, do të ketë përfundimin e njejtë sikur ato që kanë qenë deri më tani.

Adriatik Zeqiri: I nderuar kryetar, kryesues, asambleistë dhe ju musafirë, faleminderit për pyetjen, e respektuar asambleiste, pse nuk jemi përgatitur në kohë për gjysëmvetorin e dytë për ngrohje dhe a do të zëvendësohen orët e humbura? Ju e dini që puna më mediatike këto ditë përveç vërshimeve ka qenë puna e procesit arsimor të cilin jemi detyruar ta shtyjmë për një javë për arsye të rrethanave që janë krijuar në komunën tonë, pse nuk jemi përgatitur për ngrohje është pasojë e mospërgatitjeve me kohë për vite të tëra, janë tre kallda të cilat kanë qenë jashtë funksionit, përveç kësaj kemi hasë në mungesë të një kontrate aktive, kontrata është aktivizuar me datë 12.01.2026, dhe tash janë zëvendësuar kalldajat në tri shkolla të cilat nuk kanë pasur sistem të kalldajve për muaj të tërë. Patjetër që do të zëvendësohen dhe ditët e humbura, do ta planifikojmë mirë që të mos kemi problem, sa i përket kërkesave të komunitetit jemi në koordinim me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, që kjo të bëhet në mënyrën më të mirë. Kjo është përgjigja ime.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Faleminderit kryesues, shprehi dëshirën të përshëndes Kryetarin e Komunës z. Valon Prebreza, kryesuesin z. Vlonjat Hasani, të gjithë drejtorët dhe juve asambleistë, ju dëshiroj punë të mbarë. Une jam Izja Mjeku, inxhinier i elektroteknikës, pata shumë pyetje për drejtorinë të cilin e përfaqësoj, unë kam përgjigje të gjata për këto pyetje dhe ju premtoj se do të ua dërgoj të gjithëve me email, për gjendjen e mbeturinave i nderuari z. Ali Ismaili, tani z. Jetmir Berisha është menaxher i Njesisë në Fushë-Kosovë, gjendja e mbeturinave nuk është dhe nuk ka qenë aspak e mirë, ne së bashku me Kryetarin e Komunës, kemi pasur dy takime me Kryeshëfin Ekzekutiv të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi', kanë qenë vetëm tre kamion, tani i kemi tre dhe së shpejti do të kemi më shumë, ndërsa për kanalizime Komuna e Fushë-Kosovës, nuk ka asnjë kamion për pastrimin e tyre, kjo është mangësi e keqë- qeverisjes për njëzet vite, këtë e them me përgjegjësi të plotë, ne patjetër që do të thërrasim ujësjellsin dhe ata do të thërrasin Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit 'Prishtina', sepse atë kompaninë që e kemi të kontraktuar është duke i rregulluar të gjitha, problemet janë shumë të theksuara dhe nuk mund të zgjidhen brenda një kohe të shkurtë, në të ardhmen ju garantojmë, që do të përmirësohet gjendja në këto dy struktura. Ansambleiste e nderuar znj. Dardane Sogojeva Shala, numri im ka qenë në ueb-faqe të Komunës gjatë kohës së vërshimeve dhe kam pas thirrje

deri në ora tre (3) të mëngjesit dhe jam përgjigjur çdo thirrje, nuk besoj që ka ndodhur të mos përgjigjem, për detaje ju njoftoj me e-mail.

Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: I nderuar Kryesues një nga pyetjet e asambleistëve, ka të bëjë me pikën 14 dhe 15 të rendit të ditës, të cilën do ta sqarojmë kur ta shqyrtojmë këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, me qenë se nuk kemi përgjigje tjera e konstatojmë që kjo pyetje është konsumuar.

Migjen Kolshi: Kërkoj përgjigje në pyetjet e mia nga Kryetari i Komunës.

Pika e pestë (5) - Propozim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kryetari do të kthejë përgjigjet me shkrim. Tani vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës, e kemi 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa'. Ashtu siç e miratua sot, ftoj përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje, të japin dy emërat e tyre për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, propozon për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa z. Rrahim Sogojeva dhe znj. Filloreta Musaj.

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues, e ceka më herët se është duke u bërë padrejtësi, një shpërndarje jo e barabartë brenda Komitetit për Politikë dhe Financa, deshta të dija me çfarë kalkulimi e keni bërë këtë shpërndarje, tre anëtarë Lëvizjes Vetëvendosje, një Lidhja Demokratike e Kosovës, një Partia Demokratike e Kosovës, një Zëri i Drejtësisë dhe një Nisma Socialdemokrate. Materiali neve kur na ka ardhur në e-mail, sot na ka ardhur si në praktikat e kaluara, material shtesë. Kryesues, unë e kam një pyetje për ju, në bazë të cilit nen e keni bërë këtë shpërndarje, nëse Lëvizja Vetëvendosje i ka dhjetë asambleistë, Lidhja Demokratike e Kosovës i ka nëntë, pse juve duhet me ju takuar tre vende, e neve vetëm një? Unë kërkoja me mirësjellje ta shtyejmë dhe të kërkojmë interpretim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, nëse na lejon si thuani ju, ne do ta përkrahim, unë nuk e di ku jeni bazuar për këtë ndryshim, ndoshta e keni bërë për subjektet që s'keni mundur me ju dhënë Drejtori. Nëse jemi në këtë situatë ne patjetër duhet të jepim një emër, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, është emri im Laureat Gojnovci, por nëse ky vendim kalon unë zotohem që do të kërkoj interpretim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe jam i bindur, që do ta rishqyrtojmë prapë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: I nderuari kolegë, unë thashë ne po bazohemi në Udhëzimin Administrativ nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për procedurën e themelimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, ju kemi referuar, nenit 5, paragrafi 1, ku thotë Komiteti për Politikë dhe Financa - kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit, cilido qoftë ai dhe përbërja e tij, duhet të përfaqësoj përbërjen e entiteteve politike në Kuvendin e Komunës, pastaj pika e dytë thotë: entitetin politikë me numrin më të madh të vendeve, varësisht nga përfaqësimi në Kuvend do të përfaqësohet, edhe në komitet, vazhdojmë me entitetin e dytë, që ka numrin më të madh të anëtarëve të Kuvendit, e kështu me radhë deri sa të ndahen të gjitha vendet në komitet, që në këtë rast na duhen shtatë, dallimi është nëse e kishim lënë në formën si herën e parë, e dimë sigurt që ju nuk e kishit kundërshtuar, sepse i keni pas dy anëtarë në komitet, pra Lidhja Demokratike e Kosovës, e largon një anëtarë, Lëvizja Vetëvendosje, e largon një anëtarë për ta përmbushur pikën e parë të këtij neni ku thotë, duhet të ketë përfaqësim të të gjitha entiteteve politike, që po ndodhë ndoshta për herë të parë në Kuvend, që përfaqësohen edhe subjektet më të vogla, të cilat nuk kanë

qenë më herët të përfaqësura, qëllimi ynë është që të jenë të përfshira të gjitha subjektet politike. Kjo është drejtësia brenda Kuvendit të Komunës dhe po besoi, që duhet të respektohet dhe duartroket nga ju, sepse nëse të kaluarën nuk e keni pasur këtë mundësi me qenë transparent me të gjithë.

Aida Alimi: Nuk e kemi për momentin emrin.

Bashkim Krasniqi: Faleminderit Kryesues, në bazë të Udhëzimit Administrativ, vendet e komuniteteve, ndahen në bazë të rezultatit të fundit, rezultati i fundit është e para Lëvizja Vetëvendosje, e dyta Lidhja Demokratike e Kosovës, e treta Partia Demokratike e Kosovës dhe e katërta vjen Partia Liberale Egjiptiane, nëse dëshirojmë me bërë drejtësi, na duhet të jemi në këtë komitet, pse mua po më mohohet kjo e drejtë, ndoshta pse do të jem në Komitetin për Komunitete, por sot në rend dite, nuk e kemi Komitetin për Komunitete, ne e shqyrtojmë mundësinë në mbledhjen tjetër. Sot e kemi këtë pikë rend të ditës dhe mua më takon të jem pjesë e këtij komitetit, sipas Udhëzimit Administrativ, nuk po kërkojmë diçka jashtë Rregullores, vetëm drejtësi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë z. Bashkim Krasniqi, një përgjigje sa për sqarim, sipas udhëzimit të gjithë ata që janë anëtarë të një komiteti, nuk mund të jenë anëtarë të komiteteve tjera, në mbledhjen e ardhshme, ku do të jetë themelimi i Komiteteve tjera, aty detyrohemi që përfaqësues brenda komitetit të jenë të gjitha partitë e komuniteteve të komunës, atëherë detyrohemi që anëtarët e komuniteteve t'i kalojmë në Komitetin për Komunitete, kështu që kjo formë e gjithëpërfshirjes, po më habit që dissave, po ju pengon. Ta keni parasysh asnjë subjekt politikë, i cili përfaqësohet brenda Kuvendit të Komunës, nuk do të mbetet pa u përfaqësuar në dy Komitetet e Përherëshme.

Bashkim Krasniqi: Unë nuk jam pjesë e asnjë komiteti, a do të jem në Komitetin për Komunitete mbetet të shihet, për herë të parë është kjo mbledhje dhe po zgjidhet një komitet, ku nuk jam pjesë e asnjë komiteti, në mbledhjen tjetër flasim nëse më takon, e marr dhe nëse nuk me takon, nuk e marrë. Kryesues i Komiteti për Komunitete, nuk zgjidhet në bazë të rezultatit të fundit, duhet me qenë të përfshira të gjitha komunitetet, nuk jam i sigurt, ndërsa në Komitetin për Politikë dhe Financa është i sqaruar në udhëzimin administrativ, nuk e di pse unë po pengoj dhe po më mohohet kjo e drejtë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Nuk po të mohohet asnjë e drejtë, do të jesh i përfshirë në Komitetin për Komunitete, i cili do të themelohet në shkurt dhe ai është i përherëshëm, kështu që tre përfaqësuesit që jeni prezentë këtu nga komunitetet, do të jeni pjesë e komuniteteve. Nëse keni ankesë drejtoheni në organet kompetente.

Ali Ismaili: I nderuari Kryesues, po i'a filloj nga fundi, është paradoksale që ky miku im, nuk ka folur kurrë, e tani fletë, e dyta z. Bashkim Krasniqi, unë nuk e di, a mundet dikush ma mirë se t'i, Gëzimi apo Dashnimi, me i përfaqësuar më mirë komunitetet në Komitetin për Komunitete, është paradoksale t'i me kërkuar me qenë në Komitetin për Politikë e Financa, kur t'i je nga komunitetet. Dy komitetet janë të njejtë, sepse janë të themeluara mbi bazën e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nuk dallojnë aspak. Kryesues, të përgëzoj se është problem këtu, pasi që po ndodhë diçka e re dhe është problem me u përballë me të. Me dal Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, me thënë lype përgjegjësinë për bërlllog prej z. Jetmir Berisha është papërgjegjësi e tij. Unë kërkoj që të përfaqësohet dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Jetmir Berisha: Nuk isha prezentë kur më është përmendur emri, sa i përket situatës për menaxhimin e mbeturinave janë të informuara Komuna, Kompania dhe Kryetari, ne kemi

funksionuar me dy automjete, në dy javë si domos dy muajt e fundit, është vështirë të përballohen mbi një qind mijë banorë me dy automjete dhe gjendja faktike është kjo. Unë drejtë punoj dhe kur nuk më pëlqen pushteti i them Kryetarit të Komunës, se nuk mundem me punuar me ty, ne jemi Kompani, kemi kontratë me Komunën dhe do vazhdojmë punën, e presim përkrahjen institucionale, normalisht problemet janë nga qendra. Kryetari i Komunës, sa po e ka marrë detyrë dhe pres që gjendja të përmirësohet me kapacitete. Jam i kualifikuar për menaxhimin e mbeturinave nga GIZ-i gjerman dhe jam shumë i sukseshëm, jemi Njësia më e mirë me performancë në regjion me këto kapacitete që i kemi. Faleminderit nga qytetarët për besimin.

Aida Alimi: Ne kërkojmë me mirëkuptim që në mbledhjen e radhës ta sjellim në formë të shkruar propozimin tone, për anëtarë për Komitetin për Politikë dhe Financa. Shpresojmë në mirëkuptimin e juaj.

Ermal Dumani: Unë propozoj për anëtare të Komitetit për Politikë dhe Financa znj. Dardane Sogojeva Shala.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Fjala është për z. Rrahim Tërnavë, pastaj znj. Dardane Sogojeva Shala.

Rrahim Tërnavë: Mirëdita ju përsëritës të gjithëve, jemi në zgjedhjet e brendshme, unë kam vendos të mos jem më Kryetar i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës në Fushë-Kosovë, por me vazhduar si anëtarë i Këshillit Drejtues të Partisë, në nivel qendror, kështu që në Fushë-Kosovë, kemi disa vështirësi dhe ne si degë në Fushë-Kosovë, kemi vendosur me dërguar z. Migjenin si Shef të Grupit Parlamentarë, për arsye të eksperiencës që ka në Kuvendin e Komunës, si asambleisti më i vjetër nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës në Kuvendin e Komunës, ndërsa me vendim të nivelit qendror znj. Dardane Sogojeva Shala, me shkuar në Komitetin për Politikë dhe Financa. Jemi të mendimit siç kemi qenë para katër viteve, se duhet me bashkëpunuar me partitë e tjera, që të shkojë Komuna përpara, unë do të ju ftoj juve si asambleistë, me marrë iniciativë bashkarishtë me na prijë ju si Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe me dalë në aksion me pastruar këtë qytet, me i'a kthyer lulëzimin, e qytetarëve dinjitetin, sepse kemi përgjegjësi, paguhemi nga taksat e qytetarëve të ju shërbejmë për çka kemi ardhur. Ky ishte propozimi im faleminderit për mirëkuptim.

Dardane Sogojeva Shala: Unë nuk e pranoj propozimin e z. Ermal Dumani, por e pranoj propozimin e z. Rrahim Tërnavë, për Migjenin. E presim vendimin nga qendra dhe e sjellim me shkrim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Mirë atëherë a keni propozim tjetër ju të Partisë Demokratike të Kosovës për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa?

Përfaqësuesit e Partisë Demokratike të Kosovës: E sjellim në mbledhjen e radhës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne po tentojmë që me mirëkuptim të jepni emërat e juaj dhe komiteti të themelohet sot, sepse nuk mundemi të shkojmë në pafundësi duke pritur, ne mund të jepim propozimet tona dhe Komiteti të themelohet, pastaj në mbledhjen tjetër ju provoni me ndryshuar, por ne nuk dëshirojmë ashtu, me qenë se ju nuk po jepni emër atëherë emëri i Partisë Demokratike të Kosovës, mbetet pezull.

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues, propozimi im dhe i Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, është të shtyhet për mbledhjen e e radhës themelimi i Komiteti, i cili nuk konsiderohet i konstituuar pa një anëtar të Partisë Demokratike të Kosovës, nëse veç kini vendos me bërë atëherë propozoj që të shtyhet për pikën e fundit, ndoshta deri atëherë Grupi Parlamentarë

i Partisë Demokratike të Kosovës, vjen me një propozim, por ju lutem konsiderojeni me shtyer këtë çështje.

Valon Murseli: Unë kërkoj që të shtyhet themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa, në mbedhjen e radhës për arsye të pa qartësive, që i kemi edhe pse për mua është e qartë, kush kënd e përkrah një koalicion të fshehur me Lëvizjen Vetëvendosje, kush është kundër, për arsye të korrektësisë me qytetarët, kërkojmë të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Nuk jemi duke folur për Lëvizjen Vetëvendosje, jemi duke folur për këtë pikë të rendit të ditës. Tre Shefat e Grupeve Parlamentare më të mëdha të dalim jashtë, të konsultohemi për tre minuta dhe të kthehemi në mbledhje dhe të vendosim, a do të vazhdojmë me këtë pikë të rendit të ditës.

Driton Ademi: Gjithëmonë ka qenë telashe formimi i këtij komiteti, personalisht mendoj, që ka qenë diskriminim politikë ndaj meje, në një katër vjeçarë, kur Aleanca Kosova e Re, ka pasur vota më pak se Nisma Socialdemokrate, i kanë ngritur duart këtu dhe përfaqësuesi i tyre ka qenë katër vite anëtarë i këtij komiteti. E para duhet t'i referohemi Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ku thotë përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa, duhet ta reflektojë përbërjen e Asamblesë Komunale për sa i përket entiteteve politike, kështu si jemi në Kuvendin e Komunës, kështu do jemi edhe atje. Entitete politikë jemi ashtu siç na njih Komisioni Qendror Zgjedhor, kur kemi hyrë në zgjedhje dhe fryma e Komitetit për Politikë dhe Financa, është harmonizimi, atje nuk merren vendime dhe një subjekt politikë, e dinë se përfaqësuesi i tyre është pajtuar, ajo parti nuk ka nevojë me diskutuar dhe e kursejmë kohën vetës. Lidhja Demokratike e Kosovës propozoi një anëtarë, Lëvizja Vetëvendosje dy, Partia Demokratike e Kosovës, te shohim, Zëri i Drejtësisë një, si po mbetet relacioni i gjinisë ta kemi parasysh, para se me kaluar në votim, unë po pajtohem që përfaqësuesit e subjekteve të vogla me marrë një vendim, në përputhje me ligjin. Kemi pasur dy udhëzime, udhëzimi paraprak nuk e ka specifikuar përbërjen, ndërsa tjetri po. Te jemi real sepse çdo akt i Kuvendit të Komunës, i nënshtrohet procesit të ligjshmërisë dhe nuk votoj diçka që kthehet. Shpresoj në të ardhmen me pas harmoni, sa i përket vendimarrjes për Komitet.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit kolegë, Partia Demokratike e Kosovës, a jeni për ta zhvendosur këtë pikë të rendit të ditës në fund, për ndryshe është edhe pika 3, e nenit të udhëzimit administrativ ku thotë: Komiteti për Politikë dhe Financa, duhet të reflektojë barazinë gjinore në pajtim me legjislacionin në fuqi, e që deri më tani e kemi vetëm një propozim, femër nga Kuvendi i Komunës, e që duhet të jenë tre emra, po tentojmë që me mirëkuptim të themelohet ky Komitet. Propozimi i z. Driton Ademi, a është e mundshme që të kaloj propozuesi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe ju të kaloni në Komitetin për Komunitete, a jeni të pajtimit për këtë propozim, sepse do të na lehtësoni punën që të themelohet komiteti dhe të plotësohet kuota gjinore.

Driton Ademi: Bashkim Krasniqi tani, sipas ligjit shumica e thjeshtë e Komitetit për Komunitete, duhet të jetë nga Kuvendi i Komunës, kështu që t'i nëse del në Komitetin për Politikë dhe Financa, e hupni këtë element ligjor, që thotë se përbërja e Komitetit për Komunitete është vetëm me dy. Sa i përket pjesës time, unë për arsye të kuartës gjinore tërhiqem.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit për këtë përgjegjësi institucionale, e vlerësojmë shumë, atëherë si propozim do të jetë znj. Vildane Latifi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Ka ardhur një propozim nga z. Rrahim Tërnavaj, për znj. Dardane Sogojeva Shala, formalisht i kemi propozimet dhe unë propozoj, që të gjitha propozimet t'i qesim në votim një nga një. z.

Dardane Sogojeva Shala, a ka mundësi të na jepni përgjigjen tuaj finale, a doni të jeni e propozuar për tu votuar si anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Dardane Sogojeva Shala: Unë jam për të zhvendosur këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Atëherë shtyhet kjo pikë e rendit të ditës dhe e trajtojmë, pasi të përfundojnë të gjitha pikat e rendit të ditës në fund.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare për kompensimin e anëtarëve të Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani pika e gjashtë e rendit të ditës është 'Propozimi për lejimin e mjeteve financiare për kompensimin e anëtarëve të komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës'. Kuvendi i Komunës mbështetur në nenin 51, paragrafi 1 dhe të tjerat, që i kemi në tekst për procedurën e themelimit dhe përbërjen e komiteteve të përherëshme dhe të tjera, i propozon Kuvendit të Komunës, që të marrë vendim për lejimin e mjeteve financiare për Komitetet e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për mandatin 2025-2029, me ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria mallëra dhe shërbime Nr. 300, kodi ekonomik i Kuvendit të Komunës në shumën financiare prej: 100.00€ për një mbledhje, kompensimi mbulon gjithsej gjashtë mbledhje brenda vitit buxhetor dhe atë sipas formulës përkatëse si vijon: 100.00€ për gjashtë mbledhje brenda vitit që bëjnë 600.00€, për një anëtarë të Komitetit të Kuvendit, totali vjetor për një Komitet të Kuvendit është 600 x 5 anëtarë në secilin komitet bëhet 3,000.00€, pastaj totali vjetor për gjashtë Komitete është prej: 18,000.00€ dhe pagesa prej: 100.00€ e anëtarëve jashtë Kuvendit të Komunës në Komitetin për Komunitete. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve janë të definuara me Rregulloren Nr. 4 të datës 12.01.2017, për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera dhe duhet të kompensohen nga kategoria ekonomike e mallërave dhe shërbimeve e Kuvendit të Komunës.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, qëndrimi ynë, është për lejimin e këtyre mjeteve financiare për pagesën e anëtarëve të Komiteteve të Kuvendit të Komunës.

Laureat Gojnovci: Natyrisht që është mirë që komitetet të bëhen me pagesë, është një lloj motivimi, që anëtarët të punojnë me më shumë përgjegjësi, ne kemi një vërejtje pse po kalojmë në shkallën e dytë, pa kaluar në shkallën e parë, po marrim vendim për ndarjen e mjeteve financiare për diçka që nuk është themeluar ende, do të ishte mirë që të themelohen këto komitete, pastaj pasi të funksionalizohen këto komitete me ardhur ky propozim, procedura ka pa qartësi, se na nuk e dime, nëse do themelohen kështu që së pari të themelohen komitetet pastaj i votojmë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, e kuptoj këtë pjesë por është vullnet nga Kryetari i Komunës dhe kjo është një motivim plus për të gjithë anëtarët, që do të jenë pjesë e këtyre komiteteve, sepse jemi dëshmitarë që në të kaluarën janë formuar komitetet dhe nuk janë paguar anëtarët e saj. Ne po zotohemi, po ndajmë mjete financiare dhe të gjithë anëtarët, që do të jenë pjesë e tyre, do të paguhet, nuk ka asgjë të keqe këtu, megjithatë faleminderit për qëndrimin e juaj.

Migjen Kolshi: Sa i përket kësaj pike për ndarjen e mjeteve financiare, mendoi që është shumë mirë kjo, por dua të di cilat komitete janë dhe pastaj i ndajmë mjetet financiare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Komitetet dhe formimi i tyre janë të përcaktuar me rregullore dhe udhëzime, vetëm se ne po marrim vendimin për t'i zotuar mjetet financiare dhe pastaj vazhdojmë me themelimin e tyre, do të thotë dihet që do të paguhet.

Bashkim Krasniqi: Në këto Komitete do të jenë edhe anëtarët jashtë Kuvendit të Komunës dhe pagesa është e njëjta apo qysh do të jenë?

Driton Ademi: Komitetet funksionale janë shumë të rëndësishme për Kuvendin e Komunës, çështja e financimit është obligim ligjor por kam një dilemë, që kalkulimi është bërë gabim 100.00€, sepse në Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2020, neni 15, paragrafi 2 thotë: shuma e kompensimit duhet të jetë në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të Komiteteve të Përhërshme dhe me sa di unë kjo mëditje është 184.00€, sepse këtu paguhen gjashtë mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, sqarimi është ky Kuvendi vitin e kaluar e ka miratuar një buxhet, parashikimet e buxhetit kanë qenë aty dhe është e pa mundur me alokuar më shumë mjete financiare, brenda këtij viti do të shkojmë me këtë pjesë të financimit, pastaj me caktimin e buxhetit të ri, atëherë kjo do të kthehet në bazë të atij udhëzimi administrativ, siç po thoni ju, por për momentin është vetëm ky opsion, besoj të kemi mirëkuptimin tuaj për këtë pjesë, andaj kush është për aprovimin e këtij propozimi.

U votua me: njëzet e dy vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe shtatë abstenime, gjithsej njëzet e nëntë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstaton se Propozimit Nr. 02, të datës 13.01.2026, për kompensimin e anëtarëve të Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në shumën e mjeteve financiare prej: 100.00€ për secilin anëtarë të Komiteteve tjera, për gjashtë mbledhje brenda vitit fiskal aprovet dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 02, të datës 13.01.2026, për kompensimin e anëtarëve të Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në shumën e mjeteve financiare prej: 100.00€ për secilin anëtarë të Komiteteve tjera, për gjashtë mbledhje brenda vitit fiskal.
2. Shuma e mjeteve financiare e përshkruar në paragrafin 1, të këtij vendimi ndahet nga buxheti i Komunës së Fushë-Kosovës, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve - programi buxhetor i Kuvendit të Komunës dhe ka për qëllim kompensimin e anëtarëve të gjashtë Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës, në shumën e mjeteve financiare prej: 18,000.00€ dhe dy anëtarëve të Komitetit për Komunitete - përfaqësues të komuniteteve jo shumicë jashtë Kuvendit të Komunës, me shumën e lejuar të mjeteve financiare prej: 100.00€ për secilën mbledhje të këtij komiteti.

Pika e shtatë (7) - Propozim për themelimin e Grupit Punues për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pikën e radhës e kemi 'Propozimi për themelimin e Grupit Punues për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026', ashtu siç e keni marrë materialin bazuar në nenin 9 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, me Nr. 62, të datës 16.05.2013, i propozon për shqyrtim Kuvendit të Komunës marrjen e vendimit për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës, për vitin 2026', në përbërje si vijon: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës do të jetë pjesë e këtij grupi punues, Nënkryetari i Komunës, Drejtori i Drejtorisë së Administratës, Drejtori i Drejtorisë së Inspektoriatit, Zyrtari i Lartë për Kuvend dhe Komitete, një përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje, një përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, një përfaqësues i Partisë Demokratike të Kosovës, një përfaqësues i Partisë Liberale Egjiptiane, një

përfaqësues i Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës, një përfaqësues i Zërit të Drejtësisë, një përfaqësues i Nismës Socialdemokrate, një përfaqësues i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, një përfaqësues i Listës Serbe dhe një përfaqësues i Shoqërisë Civile. Detyrë dhe përgjegjësi e Grupit Punues është hartimi i planit të punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për vitin 2026.

Arlinda Mekolli: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, për anëtar të Grupit Punues për planin e punë, e propozojmë z. Kosovar Ademi.

Laureat Gojnovci: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për anëtar të Grupit Punues për planin e punë, e propozojmë z. Jetmir Berisha.

Migjen Kolshi: Në emër të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, për anëtar të Grupit Punues për planin e punë, e propozojmë znj. Aida Alimi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, u sqarua se edhe përfaqësuesit tjera të subjekteve politike të Kuvendit të Komunës, janë anëtar/e të Grupit Punues, ndërsa nga Shoqëria Civile propozohet z. Maliq Thaçi

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e nëntë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës e formon Grupin Punues për përgatitjen e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026, me anëtarët e propozuar më lartë dhe mori:

V E N D I M

1. Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026, në përbërje prej pesëmbëdhjetë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Kryetar i Grupit Punues;
 - 1.2 Shpend Bardiqi - Nënkrjetari i Komunës, anëtar;
 - 1.3 Shefqet Zogaj - Drejtori i Drejtorisë së Administratës, anëtar;
 - 1.4 Durim Hajra - Drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit, anëtar;
 - 1.5 Hasan Gjyrevci - Zyrtari i Lartë për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
 - 1.6 Kosovar Ademi - përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.7 Jetmir Berisha - përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - 1.8 Aida Alimi - përfaqësuese e Partisë Demokratike të Kosovës, anëtare
 - 1.9 Bashkim Krasniqi - përfaqësues i Partisë Liberale Egjiptiane, anëtar;
 - 1.10 Dashnim Bajrami - përfaqësues i Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës, anëtar;
 - 1.11 Ali Ismaili - përfaqësues i Zërit të Drejtësisë, anëtar;
 - 1.12 Driton Ademi - përfaqësues i Nismës Socialdemokrate, anëtar;
 - 1.13 Vildane Latifi - përfaqësuese i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, anëtare;
 - 1.14 Radoman Doderovic - përfaqësues i Listës Serbe, anëtar dhe
 - 1.15 Maliq Thaçi - përfaqësues i Shoqërisë Civile, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Grupit Punues është hartimi i Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026 dhe planeve bazë të Komiteteve të Kuvendit të Komunës.

Pika e tetë (8) - Propozim për caktimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi 'Propozimin për caktimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi', bazuar në materialin që e keni para vetes, ju takojnë dy subjekteve politike Lëvizjes Vetëvendosje një anëtarë dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës një anëtarë.

Kosovar Ademi: Propozimi ynë për anëtarë në Komisionin Komunal të Aksionarëve në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi', është z. Festim Pllana.

Laureat Gojnovci: Propozimi ynë për anëtarë në Komisionin Komunal të Aksionarëve në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi', është z. Etnik Berjani.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë dhe anëtar i tretë është i caktuar nga Kryetari i Komunës, Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit z. Izja Mjeku. Po vazhdojmë me votim kush është për.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e nëntë anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës e aprovon 'Propozimin për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve nga Komuna e Fushë-Kosovës për Kompaninë Regjionale të Mbeturinave 'Pastrimi', në përbërje prej tre anëtarëve: Festim Pllana, Etnik Berjani dhe Izja Mjeku dhe mori:

V E N D I M

1. Me këtë vendim bëhet emërimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve nga Komuna e Fushë-Kosovës për Kompaninë Regjionale të Mbeturinave 'Pastrimi', në përbërje si vijon:
 - 1.1 Festim Pllana - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, i emëruar nga Kuvendi i Komunës - anëtar,
 - 1.2 Etnik Berjani - përfaqësues nga Lidhja Demokratike e Kosovës, i emëruar nga Kuvendi i Komunës - anëtar dhe
 - 1.3 Izja Mjeku - Drejtor për Shërbime Publike përfaqësues i emëruar nga Kryetari i Komunës - anëtar.
2. Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij Komisioni janë të përcaktuara, me Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087, (Gazeta Zyrtare Nr. 31/2008) dhe dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 04/L-111, për ndryshim-plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087, për Ndërmarrjet Publike (Gazeta Zyrtare Nr. 13/2012), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, lidhur me Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare (Gazeta Zyrtare Nr. 09/2018), ligjet dhe aktet tjera nënligjore në fuqi.

Koha e pushimit në kohëzgjatje prej një ore.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Vazhdojmë me punimet e Kuvendit të Komunës.

Pika e nëntë (9) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale 'Fushë-Kosova'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimiin për lejimin e mjeteve financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale 'Fushë-Kosova' e ftojme Kryetarin e Komunës, që ta paraqes para jush këtë propozim.

Kryetari i Komunës: Faleminderit Kryesues, të nderuar të pranishëm ju propozoj që Kuvendi i Komunës të merr vendimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 200,000.00€ për

Ndërmarrjen Publike Lokale 'Fushë-Kosova' për vitin 2026, nga momenti i funksionalizimit të saj. Këto mjete financiare shuma prej 10,000.00€, do të shfrytëzohen për kapitalin fillestarë të Ndërmarrjes Publike Lokale, e cila përputhet me zotimin tim si Kryetar i Komunës, si dhe zotimin e Kryesuesit të Komunës të Komunës, për përkrahje të programeve tona buxhetore për Ndërmarrjen Publike Lokale, të cilën e kemi bërë si zotim pranë Komisionit Ndërministror si dhe plotësohet në shumën prej: 190,000.00€, nga Kodi i Programit Nr. 18162, Infrastruktura Publike në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, ndërsa kjo shumë plotësohet përveç nga buxheti për vitin 2026, edhe nga rritja e të hyrave vetjake të komunës të vitit 2025, të cilat barten për shpenzim në vitin 2026. Sqarim te Kodi i Infrastrukturës Publike, për momentin i kemi 90,000.00€, mirëpo me rialokimin e të hyrave vetjake, do të shtohen edhe shuma prej: 110,000.00€, te ky kod i programit, andaj kërkojmë aprovimin tuaj.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë Kryetar, e hapim diskutimin për Lëvizjen Vetëvendosje, qëndrimi juaj për këtë propozim të Kryetarit të Komunës.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e kemi të qartë propozimin dhe pajtohem për aprovimin e tij.

Afrim Dumani: Jemi të vetëdijshëm se për Komunën e Fushë-Kosovës, është me rëndësi të veçantë themelimi i Ndërmarrjes Publike Lokale, e cila pritet të kontribuojë drejtëpërdrejtë në mirëmbajtjen e hapësirave publike, duke ndikuar në përmirësimin e shërbimeve lokale, lidhur me këtë propozim kam disa pyetje, të drejta dhe të domosdoshme për sqarim. Kur parashihet të filloi funksionimin kjo Ndërmarrje Publike Lokale? Për cilin qëllim konkret do të shfrytëzohen mjetet financiare të propozuara?

Valon Murseli: Te kjo pikë unë dua disa sqarime shtesë, kur do të funksionalizohet dhe do të fillon operimin Ndërmarrja Publike Lokale.

Ali Ismaili: I nderuar Kryetar ka qenë kërkesë e më herëshme e Ekzekutivit të Komunës, që Ndërmarrja Publike Lokale të themelohet për arsye të shtimit të popullatës, menaxhimi është më i lehtë përmes Ndërmarrjes Publike Lokale. Nëse realizohet e përkrah, sepse mendoj, që është në dobi të qytetarëve tanë.

Kryetari i Komunës: Funksionimi i kësaj ndërmarrje pritet në muajt në vazhdim, presim vetëm vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila në mbledhjen e ardhshme do të hyjë si pikë e rendit të ditës dhe do të votohet. Qëllimi konkret i ndërmarrjes është për qëllime operative, funksionalizimi i saj, stafi elementarë, zyret janë gjëra operative me të cilën ne do të fillojmë, sepse këto mjete financiare nuk mjaftojnë, por do të shfrytëzojmë kode buxhetore tjera, që janë të parapara për blerjen e makinave për drejtori të caktuara, në mënyrë që t'i shfrytëzojmë për Ndërmarrjen Publike Lokale. Aktivitetet janë mirëmbajtja e qytetit, hyrjeve banesore, rregullimi i parqeve, mirëmbajtja e varrezave në tërë territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, mirëmbajtja e objekteve publike, do të thotë eliminimi i të gjithë tenderëve, që kanë qenë deri tani për mirëmbajtje, do t'i zëvendësojmë me këtë Ndërmarrje Publike Lokale. Njëkohësisht gabimet që janë bërë te pranimi i stafit teknik në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë dhe sektorin e arsimit, ku janë bllokuar normat për profesionistë këto do t'i zëvendësojmë, pra stafi teknik në shëndetësi dhe i shkollave, do të kalojnë në Ndërmarrjen Publike Lokale, në mënyrë që këto të zëvendësohen me norma për arsim dhe shëndetësi. Mirëmbajtjen e ashensorëve do ta vlerësoi menaxhmenti i ndërmarrjes dhe për secilin veprimtari, që mendojmë se është e drejtë do të shtohet në ndërmarrje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit Kryetar për sqarimet, vazhdojmë me votim kush është për këtë propozim?

U votua me: njëzet e pesë vota 'për', dy vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, kosntatoi se me shumicë të votave Kuvendi i Komunës, e aprovon 'Propozimin për ndarjen e shumës së mjeteve financiare prej: 200,000.00€ për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova' dhe mori:

V E N D I M

1. Me këtë vendim lejohet ndarja e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej: 200,000.00€, për funksionimin dhe operimin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova, në vitin fiskal 2026, me shpërndarjen e tyre si vijon:
 - 1.1 Shuma e mjeteve financiare prej: 10,000.00€, destinohet për kapitalin fillestar të Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova dhe
 - 1.2 Shuma e mjeteve financiare prej: 190,000.00€, destinohet për funksionimin operativ të Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova.
2. Shuma e mjeteve financiare e përshkruar në paragrafin 1, të këtij vendimi ndahet nga buxheti i Komunës së Fushë-Kosovës, kategoria ekonomike e subvencioneve - programi buxhetor Nr. 18162 Infrastruktura Publike dhe ka për qëllim dhënie e ndihmës financiare për shtimin e kapitalit të punës, me bartjen e mjeteve financiare nga buxheti i komunës për vitin 2026 dhe rritja e të hyrave vetjake e vitit 2025, të bartura për shpenzim në vitin 2026, tek Ndërmarrja Publike Lokale - Fushë Kosova.

Pika e dhjetë (10) - Propozim për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 91, të datës 31.03.2022 për ndërtimin e Stacionit të Policisë në Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kalojmë në pikën e radhës që është 'Propozim për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 91, të datës 31.03.2022 për ndërtimin e Stacionit të Policisë në Fushë-Kosovë', e ftojme Kryetarin e Komunës që të jap këtë propozim.

Kryetari i Komunës: Të nderuar me datë 06.01.2026, është parashtruar 'Kërkesa Nr. 05 nga Drejtori i Departamentit për shërbime mbështetëse, që të plotësohet-ndryshohet një vendim i këtij Kuvendi', që ka qenë për Stacionin e Policisë në Fushë-Kosovë, arsyeja është se kërkohet nga niveli qendror, që këtij stacioni t'i shtohet edhe Agjensioni i Regjistrimit Civil, ku hyn Qendra për Paisje me Dokumenta dhe Qendra për Regjistrimin e Automjeteve, është kërkesë legjitime në mënyrë që të procedohet si projekt dhe e kemi marrë si të mirë qenë, këtë kërkesë dhe e kemi shtruar para juve për shqyrtim, andaj kërkojmë aprovimin tuaj që Stacionit Policor t'i shtohet Agjensia e Regjistrimit Civil dhe Qendra për Regjistrimin e Automjeteve.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, pajtohem i për ndryshimin e vendimit në fjalë.

Laureat Gojnovci: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, pajtohem i edhe ne për ndryshimin e vendimit në fjalë.

Valon Murseli: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, pajtohem i edhe ne për ndryshimin e vendimit në fjalë.

Ali Ismaili: Deshta të bëjë një pyetje, nuk e kuptoj pse të bëhet ky plotësim-ndryshim, kur ne i'a kemi dhënë ngastrën kadastrale?

Kryetari i Komunës: Kërkesë është që Agjensia e Regjistrimit Civil dhe Qendra për Regjistrimin e Automjeteve, të përfshihen aty, në mënyrë që të ndërtohet si titull komplet, vendimi është vetëm plotësohet.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Vazhdojmë tani me votim kush është për aprovimin e 'Kërkesës për ndryshim-plotësimin e paragrafi 1, i vendimit Nr. 91, i datës 31.03.2022, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për Stacionin e Policisë në Fushë-Kosovë, me vendosjen në sipërfaqen e objektit të ri të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për ndërtimin e objektit të ri, me destinim për Policinë e Kosovës dhe Agjensinë e Regjistrimit Civil, me njësitë tjera si vijon: Qendra për Pajisje me Dokumente - QPD dhe Qendra për Regjistrimin e Automjeteve - QRA.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e dy anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se ndryshohet-plotësohet paragrafi 1, i vendimit Nr. 91, i datës 31.03.2022, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për Stacionin e Policisë në Fushë-Kosovë, me vendosjen në sipërfaqen e objektit të ri të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për ndërtimin e objektit të ri, me destinim për Policinë e Kosovës dhe Agjensinë e Regjistrimit Civil, me njësitë tjera si vijon: Qendra për Pajisje me Dokumente - QPD dhe Qendra për Regjistrimin e Automjeteve - QRA dhe mori:

V E N D I M

1. Me këtë vendim ndryshohet-plotësohet paragrafi 1, i vendimit Nr. 91, i datës 31.03.2022, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për Stacionin e Policisë në Fushë-Kosovë, me vendosjen në sipërfaqen e objektit të ri të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për ndërtimin e objektit të ri, me destinim për Policinë e Kosovës dhe Agjensinë e Regjistrimit Civil, me njësitë tjera si vijon:
 - 1.1 Qendra për Pajisje me Dokumente - QPD dhe
 - 1.2 Qendra për Regjistrimin e Automjeteve - QRA.

Pika e njëmbëdhjetë (11) - Propozim për dhënien në shfrytëzim të objektit të Ambulantës së Mjekësisë Familjare për Zyre Sektoriale Policisë së Kosovës në Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Propozimi për dhënien në shfrytëzim të objektit të Ambulantës së Mjekësisë Familjare për zyre sektoriale të Policisë së Kosovës në Fushë-Kosovë, e ftojme Kryetarin e Komunës, ta paraqesë këtë propozim.

Kryetari i Komunës: Të nderuar të pranishëm është 'Kërkesë e Stacionit të Policisë në Fushë-Kosovë për marrjen në shfrytëzim të objektit në lagjen Dardania, konkretisht Kompleksi 300', në mënyrë që të shfrytëzohet ky objekt për zyre sektoriale dhe ndihmë e Stacionit Policor të Fushë-Kosovës, në mënyrë që shërbimet ndaj qytetarëve të jenë më efikase dhe më të shpejta. Në raportin e fundit nga Stacioni i Policisë, është vërejtur që intervenimi zgjat disa minuta, në mënyrë që intervenimi të jetë më i shkurtër, propozojmë që ky objekt t'i jepet në shfrytëzim Stacionit të Policisë së Fushë-Kosovës.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, pajtohem që të aprovohet 'Kërkesë e Stacionit të Policisë në Fushë-Kosovë për marrjen në shfrytëzim të objektit në lagjen Dardania, konkretisht Kompleksi 300 për Zyre Sektoriale'.

Laureat Gojnovci: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, edhe ne pajtohem që të aprovohet 'Kërkesë e Stacionit të Policisë në Fushë-Kosovë për

marrjen në shfrytëzim të objektit në lagjen Dardania, konkretisht Kompleksi 300 për Zyre Sektoriale’.

Migjen Kolshi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, edhe ne pajtohemi që të aprovohet ‘Kërkesë e Stacionit të Policisë në Fushë-Kosovë për marrjen në shfrytëzim të objektit në lagjen Dardania, konkretisht Kompleksi 300 për Zyre Sektoriale’.

Ali Ismaili: Është kërkesë e mëherëshme, që mendoj që është e drejtë dhe do ta mbështes, mirëpo ajo me sa di unë ju është dhënë një Organizatë Jo Qeveritare nga Ish/ Nënkryetari i Komunës z. Besnik Osmani, e cila është nën ombrellën e Bashkësisë Islame të Kosovës, të cilën e falenderova për punën e saj, nuk e di, a keni diskutuar me ta, që të mos kemi telashe për ndryshe po, ne jemi për këtë propozim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, sa për sqarim dhënien në shfrytëzim të pronave të komunës, e vendos Kuvendi i Komunës dhe jo individë të caktuar, kjo është dhënë pa konsultim në Kuvendin e Komunës dhe ne mbesim të propozimi i Kryetarit të Komunës. Nëse s’ka diskutime tjera, po e qesim në votim, kush është për.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e tre anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se aprovohet ‘Propozimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës - objektit të Ambulancës së Mjekësisë Familjare, për plotësimin e nevojave të Stacionit të Policisë në Fushë-Kosovë, për një Zyre Sektoriale, në lagjen e Dardanisë të banesat e Kompleksit 300 në rrugën ‘Ago Imeri’ në Fushë-Kosovë dhe mori:

V E N D I M

1. Për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës - objektit të Ambulancës së Mjekësisë Familjare, për plotësimin e nevojave të Stacionit të Policisë në Fushë-Kosovë për një Zyre Sektoriale, në lagjen e Dardanisë të banesat e Kompleksit 300 në rrugën ‘Ago Imeri’ në Fushë-Kosovë.
2. Prona e komunës shfrytëzohet me mirëbesim dhe i shërben Policisë së Kosovës, për zbatimin e detyrave operative për interesin e përgjithshëm të qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e dymbëdhjetë (12) - Propozim për rishqyrtimin e vendimeve për Projekt-Planit Zhvillimor Komunal për vitet 2025/2033.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Propozimi për rishqyrtimin e vendimeve të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal për vitet 2025-2033, ky vendim është kthyer nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, se është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, andaj në bazë të këtij verifikimi të Ministrisë, kërkohet që pas këtij shqyrtimi, të propozohet që të anulohet ky vendim, ne po hapim diskutimin.

Kosovar Ademi: në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, pajtohemi që të bëhet anulimi i këtyre dy vendimeve.

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues, tani siç e dimë Plani Zhvillimor Komunal është miratuar me datë 22.09.2025, e që vlerësojmë se ka respektuar të gjitha procedurat e Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe Udhëzimin Administrativ për hartimin, monitorimin dhe zbatimin e planit urban. Ligji i Planifikimit Hapësinor, është i qartë dhe nuk i jep kompetencë Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, që të planifikojnë për komuna dhe

interpretimi, se komuna duhet të pajiset me pëlqim paraprak, pas leximit të parë për me shkuar në dëgjim publik, është ndërhyrje direkte e Ministrisë dhe ne e dime, pse kjo ka ndodhur kjo, është tejkalim i kompetencave të saj, e që ka ndodhur vetëm me komunën tonë. Kryesuesi e theksoi Ligjin, por ky ligji me Nr. 04/L-174, neni 11 thuhet se, komuna e dorëzon projektin për verifikim, se a është Plani Zhvillimor Komunal në harmoni me Planin Hapësinor të Republikës së Kosovës, dhe me Hartën Zonale të Kosovës, të vetmin argument Ministria e ka pasur këtë. Nuk ka plan të miratuar nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës prej vitit 2010 deri në vitin 2020, bazuar në këto rrethana unë do të kërkoja nga Ekzekutivi i Komunës të na përgjigjet, ku verifikohet përputhshmëria e Planit Zhvillimor Komunal të Fushë-Kosovës, me cilin dokument. Unë po ju bëj thirrje, që ky plan të mbetet në fuqi, sepse kështu lejohet kompetenca e Komunës të zbatohet, që nuk lejon Ministrinë, që të interferoi në kompetencat e Komunës së Fushë-Kosovës. Plani Zhvillimor Komunal është kompetencë e Kuvendit të Komunës, nëse është në kundërshtim me ligjin, thuani dhe e keni përkrahjen tonë.

Migjen Kolshi: Plani Zhvillimor Komunal që ka qenë më herët nuk e ka pasur përkrahjen tonë, është miratuar me një shumicë të thjeshtë, ne kemi qenë kundër atij plani.

Driton Ademi: Vendimet e këtij Kuvendi të Komunës zakonisht nuk kthehen nga Ministria, nëse e keni komentin e Ministrisë, nuk është dashur të bëhet debat në Kuvend, pa u harmonizuar me Planin Zhvillimor të Kosovës, Hartën Zonale të Kosovës e tjera. Çështja këtu është se ose duhet të suspendohet ky vendim, deri në rishqyrtimin e radhës, nëse jemi të gatshëm për rishqyrtim e shfuqizojmë, unë jam dakord me komentin e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës.

Ali Ismaili: Ne këtë vendim e kemi marrë në mbledhjen e fundit të legjislaturës së kaluar dhe brenda afatit ligjor Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, e ka kthyer si të kundërligjshme, madje na s'kemi mbajtur mbledhje dhe mua më ka ardhur në e-mail si Kryesues i Kuvendit të Komunës, ku Ministria në fjalë na njofton se jemi vonuar në afate kohore për tre njoftimet, që sot kanë ardhur në rishqyrtim në Kuvendin e Komunës. Unë mendoj, se këto vendime duhet të shfuqizohen dhe kam një pyetje për ju Kryesues, a do të jemi të penalizuar në kuptimin ekonomik që duhet me paguar prapë atë, që vazhdon me Planin Zhvillimor Komunal mbi bazën e idesë që Kryetari i Komunës, e sheh tani rreth kërkesave të qytetarëve.

Drejtori për Planifikim Urban: Përshëndetje, procedurë e prokurimit është ajo, se a duhet me ndarë, por diçka që kemi vërejtur në planin ekzistues, se ka gabime teknike, e kemi projektuar rrugën 'Doruntina' me Planin Zhvillimor të Komunës, planin aktual, është projekti ekzistues për kolektor i cili bëhet prej Uglarit deri në Bresje, nuk është i përfshirë në projekt fare, këto dy pika nuk janë të përfshira në Planin Zhvillimor Komunal, nëse ne vazhdojmë me këtë Plan s'kemi me mundur me i realizuar këto projekte publike.

Ali Ismaili: Drejtor nuk pajtohem me ty kur thua, se kjo pjesë është e tenderimit, planet duhet të hartohen nga Drejtoria e Planifikimit Urban, por më herët kanë thënë se nuk kanë kapacitete në Drejtorinë e Planifikimit Urban, se ka vetëm dy arkitektë dhe e kanë marrë 'Kompaninë Insi'. Pyetja ime është, a do ta bësh t'i si drejtor me stafin tënd Planin Zhvillimor Komunal, apo do të bëni kërkesë te Kryetari i Komunës për të ndarë mjete financiare për Kompaninë Insi?

Nënkryetari i Komunës: Kontrata është ende aktive me kompaninë në fjalë, na ka borxhe ende punë dhe do të vazhdojmë me ta deri në përfundimin e kësaj kontrate.

Drejtori për Planifikim Urban: Fatëkeqësisht e bëre një gabim, nëse mendon se arkitektat e bëjnë Planin Zhvillimor Komunal, duhet një staf prej ekonomistave, juristave, inxhinerave dhe kjo nuk është vetëm në domenin e planifikimit urban.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, atëherë kush është 'për' anulimin e vendimit me Nr. 70, i cili ka të bëjë me hapjen e shqyrtimit publik për Planin Zhvillimor Komunal Fushë-Kosova për vitet 2025-2033.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej tetëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave e anulon vendimit Nr. 70, të datës 25.07.2025, për hapjen e shqyrtimit publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2033, sipas shkresës Nr. 5852-2/25, të datës 14.08.2025, të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës dhe mori:

V E N D I M

Për anulimin e vendimit Nr. 70, të datës 25.07.2025, për hapjen e shqyrtimit publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2033, sipas shkresës Nr. 5852-2/25, të datës 14.08.2025, të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës.

Atëherë vazhdojmë me vendimin me Nr. 97, kush është për anulimin e këtij vendimi, i cili ka të bëjë me miratimin e Planit Zhvillimor Komunal Fushë-Kosova për vitet 2025-2033.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej nëntëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave Kuvendi i Komunës e bënë anulimin e vendimit Nr. 97, të datës 24.09.2025, për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2033, sipas shkresës Nr. 7243-2/25, të datës 14.10.2025, të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës dhe mori:

V E N D I M

Për anulimin e vendimit Nr. 97, të datës 24.09.2025, për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2033, sipas shkresës Nr. 7243-2/25, të datës 14.10.2025, të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës.

Pika e trembëdhjetë (13) - Propozim për rishqyrtimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shkollës në fshatin Lismir.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Propozimi për rishqyrtimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shkollës në fshatin Lismir. Fjala është për drejtorin z. Taulant Kelmendi.

Drejtori për Planifikim Urban: Përshëndetje për të gjithë, tani Kuvendi i Komunës ka marrë vendimin Nr. 98, të datës 24.09.2025, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shkollës në fshatin Lismir, në përputhje me propozimin Nr. 793 të datës 23.07.2025, të Drejtorisë së Arsimit, vendimit Nr. 98 i datës 24.09.2025, është vlerësuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, se është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të planifikimit hapësinor sipas shkresës Nr. 7244-2/25 të datës 14.10.2025, andaj ne propozojmë që ky vendim të shfuqizohet pas rishikimit të tij

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, ne jemi për shfuqizimin e këtij vendimi të vlerësuar si të kundërligjshëm nga Ministria kompetente për këtë çështje.

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues, ne po flasim për ndërtimin e një shkolle në fshatin Lismir, këtu Drejtori për Planifikim Urban nuk na tha saktë, se cilin ligj apo nen ky vendim e ka shkelur, pse nuk i keni marrë hapat e nevojshëm si në pikën paraprake, për të bërë ndryshim-plotësim edhe këtu, tani Ekzekutivi i kaluar i Komunës, ka pas marrëveshje për ndërtimin e një shkolle në bashkëfinancim me Bashkësinë Islame të Kosovës, pasi që shkolla në fshatin Lismir nuk i përmbusë më as kriteret minimale për zhvillim të mësimi aty. Në domenin e këtij Kuvendi të Komunës, është të caktohet lokacioni, se kush e ndërton është çështje që ju e zgjidhni mes vete, unë besoj se nuk duhet të shfuqizohet ky vendim Drejtori për Planifikim Urban dhe Drejtori për Arsim, duhet me ardhur me propozim për të ndryshuar-plotësuar, mangësitë e këtij vendimi që të hapen rrugët për ndërtimin e shkollës së re në fshatin Lismir.

Ali Ismaili: Kryetar në Lismir, ka nevojë për një shkollë, andaj apeloj që sa më shpejtë të kryhen procedurat, me qëllim që ta bëjmë një shkollë në bashkëpunim me Drejtorin e Planifikimit Urban, aty ku na lejon ligji.

Driton Ademi: Është mirë të respektohen dokumente strategjike të komunës Plani Zhvillimor Komunal dhe Harta Zonale e Komunës, tani Drejtori i Planifikimit Urban mundet me na treguar se çdo pjesë, për çka është e destinuar dhe ne të kemi të qartë, pse po kërkohen shfuqizimi i këtij vendimi.

Kryetari i Komunës: Lismiri ka problem me shkollë për disa vite, në komunë nuk kemi asnjë dokument për prona të komunës se cilat janë. Drejtori për Planifikim Urban shumë mirë e përshkruajti kur tha se në Planin Zhvillimor Komunal nuk ka asnjë projekt madhor. Ajo shkollë nuk mund të ndërtohet në atë lokacion, se ku do të ndërtohet mbetet të shihet bashkë me Drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban.

Drejtori për Planifikim Urban: Sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës, aty nuk parashihet të jetë objekti shkollorë, aty kemi zonë tregtare dhe zonë bujqësore, ky vendim është i kundërligjshëm, sepse ju dhjetë herë e keni shqyrtuar, e disa herë e keni miratuar 'Rregulloren për bonuse të ndërtimit me kompenzim', por ajo është vlerësuar si e kundërligjshme, nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, andaj në periudhën vijuese keni vepruar jashtë rregullave ligjore në proceset e ndërtimit, përfshirë edhe ndërtimin e këtij objekti shkollorë në fshatin Lismir.

Laureat Gojnovci: Shkolla është zhvendosur për arsye të ndërtimit të impiantit për ujëra të zëza në nivel regional, ku pjesë e debatit kanë qenë edhe përfaqësuesit e Bashkimit Evropian nga Franca dhe Gjermania, këtu po manipuloni me projektin e Bashkimit Evropian që është me miliona, kjo shkollë duhet të ndërtohet, sepse shkolla e vjetër nuk i përmbush standardet e kohës për zhvillimin e procesit mësimorë, unë jam që ta plotësojmë këtë vendim dhe ta ndërtojmë shkollën e re në fshatin Lismir.

Kryetari i Komunës: Unë i di mirë zotimet e dhëna për KfV-në dhe donatorin francezë, por ju nuk e keni dorëzuar dokumentacionin për zhvillimin e zonës në fjalë, e keni ndërruar lokacionin për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza, nga zona tek 'Hib-Petroli', në fshatin Lismir, ju këto projekte të mëdha nuk i keni vendosur fare në dokumentet strategjike zhvillimore, sepse keni punuar pa plane.

Nënkryetari i Komunës: Ju punën e keni bërë pa plan, e kemi shqyrtuar me dhjetëra herë në Kuvendin e Komunës 'Rregulloren e bonuseve për ndërtime të larta', njësoi keni vepruar edhe me objektin e Xhamisë në Fushë-Kosovë, por të gjitha këto vendime të Kuvendit tonë, në mandatin e kaluar janë vlerësuar të kundërligjshme, por ju i keni lënë prapë në fuqi, pa asnjë ndryshim të tyre.

Kryetari i Komunës: Ne do ta ndërtojmë një shkollë të re, për banorët e fshatit Lismir dhe lagjes së Nakaradës, në pronat e Korporatës Energjetike të Kosovës, pas marrjes së pëlqimit paraprak nga ata, sepse ne mendojmë me vizion për të gjithë zonën në fjalë, meqë numri i nxënësve në zonat e fshatrave është duke u zvogëluar.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve tjera Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për shfuqizimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shkollorë në fshatin Lismir'.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për shfuqizimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shkollorë në fshatin Lismir' dhe mori:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit Nr. 98, të datës 24.09.2025, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shkollorë në fshatin Lismir, sipas shkresës Nr. 7244-2/25, të datës 14.10.2025, të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës.

Pika e katërbëdhjetë (14) - Propozim për rishqyrtimi e vendimit për shujtën e punëtorëve të Administratës Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozim për rishqyrtimi e vendimit për shujtën e punëtorëve të Administratës Komunale'. Hap diskutimin.

Laureat Gojnovci: E njëjta çështje, edhe këtë vendim propozoni, që të bëhet shfuqizimi i vendimit për pagesën e shujtës së punëtorëve të Administratës Komunale, unë propozoi që këtë vendim të ndryshojmë dhe plotësojmë për vitin 2026, të lejojmë një buxhet për pagesën e shujtave të punëtorëve të Administratës Komunale, meqë kjo punë është vendosur si praktikë, në shumicën e Komunave të Kosovës.

Valon Murseli: Nëse ka ndonjë zgjidhje në aspektin ligjorë, ne jemi që ky vendim mos të anulohet, por të shikohen mundësitë ligjore dhe financiare për zbatimin e tij.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Për këtë çështje e kemi vlerësimin e Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, i cili thotë se kjo punë nuk është e mbështetur në ligj, po ashtu nuk është e planifikuar në buxhetin e komunës, andaj këtë vendim ne duhet ta shfuqizojmë.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për shfuqizimin e vendimit Nr. 95, të datës 24.09.2025, për kompensimin vjetor për financimin e ushqimit për punëtorët e Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës, sipas shkresës Nr. 3002-1/2025, të datës 07.10.2025, të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve' dhe mori:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit Nr. 95, të datës 24.09.2025, për kompensimin vjetor për financimin e ushqimit për punëtorët e Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës, sipas shkresës Nr. 3002-1/2025, të datës 07.10.2025, të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Pika e pesëmbëdhjetë (15) - Propozim për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës me Nr. 68, të datës 25.07.2025.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës me Nr. 68, të datës 25.07.2025', ftoi Drejtoreshën për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që të na jap sqarime.

Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: Mjete financiare në buxhet për mbulimin e shpenzimeve për 43 vende të punës nuk i kemi, në vitin 2026, janë të planifikuara me buxhet, vetëm 24 vende të punës, andaj pas shqyrtimit Kryetari i Komunës, ka vendosur të bëjë anulimin e procedurave të zhvilluara për këto vende të punës, jashtë planifikimit buxhetor, për konkurset publikë me Nr. 849 dhe 850, andaj edhe ne tani kërkojmë anulimin e vendimit Nr. 68, të datës 25.07.2025.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, pajtohem që vendimi në fjalë të anulohet, arsyetimet u dhanë nga Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Laureat Gojnovci: Me anulimin e këtij vendimi dhe procedurave të zhvilluara të konkurseve publike, tani Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Ambulancat e Mjekësisë Familjare, në territorin e komunës, do të jenë para kollapsit, sepse ka mungesë të personelit shëndetësorë, për mbulimin e të gjitha shërbimeve, meqë numri i vizitave mjekësore dhe shërbimeve përcjellëse mjekësore në komunën tonë është i madh.

Valon Murseli: Ne nuk jemi pajtuar as kur është marrë ky vendim në mandatin e kaluar, andaj nuk do të marrim pjesë në votim as tani.

Migjen Kolshi: Qëndrimi ynë është dhënë në muajin qershor, edhe për vendimin e shëndetësisë, edhe për vendimin e arsimit, pse nuk po merreni edhe me vendimin e arsimit.

Kryetari i Komunës: Punëtorët e arsimit i kanë nënshkruar kontratat e punës, ne do ta gjejmë një zgjidhje për punëtorët teknik të shëndetësisë dhe arsimit, me formimin e Ndërmarrjes Publike Lokale, i kemi 58 punëtorë të stafit teknik, për këtë çështje sqarime shtesë duhet të jap tani Drejtori për Buxhet dhe Financa.

Laureat Gojnovci: Këta punëtorë kanë marrë pjesë në procedura të konkursit, një pjesë janë punëtorë të projektit të Karitasit, kanë edhe raporte kontraktuale në familje, andaj nuk duhet të ndërpriten kontratat e punës së tyre.

Ali Ismaili: Këto punësime kanë qenë puro-politike, i njëjti shabllon është përdorë edhe me kategorinë e subvencioneve, të gjitha janë përdorë për zgjedhje, ne e kemi vënë në pah këtë fakt, por ka mbizotëruar mbivotimi në Kuvendin e Komunës nga Ish/Pushteti.

Driton Ademi: Edhe ne nuk jemi pajtuar me këtë qasje, por tani kërkojmë që punëtorët e projekteve, që kanë punuar me vite, nëse ka mundësi të mos largohen nga puna.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e qesim në votim 'Propozimin për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës me Nr. 68, të datës 25.07.2025'.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës me Nr. 68, të datës 25.07.2025' dhe mori:

V E N D I M

Për anulimin e vendimit Nr. 68, të datës 25.07.2025, për aprovimin e Kërkesës Nr. 627, të datës 17.06.2025, për shpalljen e vendeve të reja të punës dhe ndarjes së mjeteve buxhetore për vitin 2026 për punëtorë shëndetësorë.

Pika e gjashtëmbëdhjetë (16) - Propozim për lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore primare në mjekësinë familjare për kategoritë me rëndësi të veçanta për sigurinë publike.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore primare në mjekësinë familjare për kategoritë me rëndësi të veçanta për sigurinë publike', ftoi Drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale, që të na jap sqarime.

Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: Sqaroj propozimin në fjalë, që konsiston në lirim nga pagesat e shërbimeve në shëndetësinë parësore, kategoritë që punojnë në sigurinë e përgjithshme sikur janë: Policia e Kosovës, Pjestarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Zjarrëfiksat, andaj ju ftoi të gjithëve që ta aprovonin propozimin tonë.

Jetmir Berisha: Kërkoj që në këtë lirim të hyjnë edhe punëtorët e Njesisë së Pastrimit të Komunës tonë, meqë janë më të rrezikuarit nga puna e tyre në teren.

Ali Ismaili: Në këtë lirim të shërbimeve parësore shëndetësore, duhet të hyn edhe qytetarët me origjinë nga Lugina e Preshevës, të cilët kanë shumë vështirësi me dokumentacionin e tyre.

Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: Pajtohem që në këtë lirim të hyjnë 'Njësia e Pastrimit', ndërsa për qytetarët me origjinë nga Lugina e Preshevës, do ta shqyrtojmë këtë çështje dhe do ta gjejmë një zgjidhje të përshtatshme dhe ligjore, në periudhën e ardhshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e qesim në votim 'Propozimin për lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore primare në mjekësinë familjare për kategoritë me rëndësi të veçanta për sigurinë publike', me përfshirjen në vendim edhe të punëtorëve të 'Njesisë së Pastrimit në Fushë-Kosovë'.

U votua unanimisht nga ta pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave, e aprovoi 'Propozimin për lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore primare në mjekësinë familjare për kategoritë me rëndësi të veçanta për sigurinë publike', me përfshirjen në vendim edhe të punëtorëve të 'Njesisë së Pastrimit në Fushë-Kosovë' dhe mori:

V E N D I M

1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e shërbimeve shëndetësore primare, në mjekësinë familjare të gjitha kategoritë me rëndësi të veçantë për sigurinë publike me shërbim publik, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës si vijon:
 - 1.1 Pjesëtarët e Policisë së Kosovës;
 - 1.2 Pjesëtarët aktivë të Forcës së Sigurisë së Kosovës;
 - 1.3 Pjesëtarët e njësive profesionale të Zjarrëfiksëve dhe
 - 1.4 Pjesëtarët e Kompanisë Regjionale të Mbeturinave 'Pastrimi' - Njësia e Komunës së Fushë-Kosovës.

2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Shëndetësi me njësitë e saj: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Ambulantat e Mjekësisë Familjare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani sqarojmë se do të votojmë për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, andaj kërkojmë nga Lidhja Demokratike e Kosovës, që ta jap propozimin e saj.

Laureat Gojnovci: Ne nuk pajtohemi me këtë qasje, ku z. Ali Ismaili dhe z. Driton Ademi të përfaqësohen njësoi me neve, që i kemi nëntë anëtarë në Kuvendin e Komunës. Kjo punë nuk është në rregull, andaj ne e tërheqim propozimin tonë.

Migjen Kolshi: Mos e përdorni arrogancën e numrave, ne propozimin tonë do ta japim në mbledhjen e radhës, andaj kërkojmë që kjo pikë e rendit të ditës, votimi të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Rrahim Tërnavaj: Ne e propozojmë për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa znj. Dardane Sogojeva Shala.

Laureat Gojnovci: Edhe ne pajtohemi me propozimin e Migjenit, që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Ermal Dumani: Unë pajtohemi që të jetë z. Dardane Sogojeva Shala.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas sqarimeve lexoi emrat e të propozuarve si vijon: Vlonjat Hasani - Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa, Filloreta Musaj, Rrahim Sogojeva, Dardane Sogojeva, Ali Ismaili dhe Vildane Latifi, të cilët i qesim tani në votim.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim, e aprovoi 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa në përbërje si vijon: Vlonjat Hasani - Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa, Filloreta Musaj, Rrahim Sogojeva, Dardane Sogojeva, Ali Ismaili dhe Vildane Latifi dhe mori:

V E N D I M

1. Për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej shtatë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës;
 - 1.2 Filloreta Musaj - Lëvizja Vetëvendosje, anëtarë;
 - 1.3 Rrahim Sogojeva - Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.4 Përfaqësuesi nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar/e;
 - 1.5 Dardane Sogojeva Shala - Partia Demokratike e Kosovës, anëtarë;
 - 1.6 Ali Ismaili - Zëri i Drejtësisë, anëtar dhe
 - 1.7 Vildane Latifi - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, anëtarë.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komitetit për Politikë dhe Financa, është shqyrtimi i të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore afatmesme buxhetore, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim gjatë vitit fiskal,


si dhe marrjen e raportit nga Kryetari i Komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës

Pika e shtatëmbëdhjetë (17) - Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani jemi në pikën 'Të ndryshme', ftoi të pranishmit nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 15:50h.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

